

Doracak për arsimtarë

**NOTIMI
FORMATIV
NË MËSIMIN
KLASOR**



Doracak për arsimtarë

**NOTIMI
FORMATIV
NË MËSIMIN
KLASOR**



Биро за развој на образованието

Shkup, 2015

DORACAK

Titulli:

NOTIMI FORMATIV
NË MËSIMIN KLASOR

Botues: Byroja për Zhvillimin e Arsimit

Për botuesin: mr. Vesna Horvatoviq

Redaktor: mr. Vesna Horvatoviq

Autor: mr. Gorica Mickovska, Andrijana Tasevska

Recenzentë: mr. Anica Aleksova, mr. Mitko Çeshllarov

Përkthimi në gjuhën shqipe: mr. Satki Ismaili

Dizajni: KOMA

Shtypshkronja: Vinsent Grafika

Tirazhi: 1000 ekzemplar

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

37.091.212.6-057.874-056.36(035)

MICKOVSKA, Gorica

Notimi formativ në mësimin klasor : doracak / [autor Gorica Mickovska, Andrijana Tasevska ; përkthimi në gjuhën shqipe Satki Ismaili]. - Shkup : Byroja e zhvillimit të arsimit, 2015. - 78 стр. : илустр. ; 30 см

-- Notimi formativ të nxënësit me vështirësi në mësim : plotësim i Doracakut për arsimtarë për notimin formativ në mësimin klasor. - 15 str. : tabeli ; 30 см

ISBN 978-608-206-047-7

1. Tasevska, Andrijana [автор]

а) Ученици со потешкотии во учењето - Методи на проверување - Прирачници

COBISS.MK-ID 99322890

Doracaku është i përpiluar me përkahjen finansiare dhe të ekspertëve të Zyrës së UNICEF-it, Shkup.

Botimi është përgatitur me ndihmën profesionale nga Qendra Maqedonase për Arsim Qytetar.

Qëndrimet e prezantuara në këtë doracak janë të autorëve dhe nuk do të thotë se përputhen me qëndrimet dhe politikat e UNICEF-it, Byrosë së Zhvillimit të Arsimit (BZHA) dhe Qendrës Maqedonase për Arsim Qytetar (QMAQ).

unicef 



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
ГРАЃАНСКО
ОБРАЗОВАНИЕ

PËRMBAJTJA

HYRJE 7

1. Çka është notimi formativ?11

1.1. Definimi dhe përdorimi 11

1.2. Si notimi formativ e përmirëson të mësuarit dhe të arriturat?14

2. Parashtrimi i qëllimeve dhe rezultatet e pritura/kriteret për sukses..... 19

Pse është me rëndësi?..... 19

Çka janë qëllimet arsimore, rezultatet e të mësuarit dhe detyrat?20

2.1. Qëllimet20

2.2. Rezultatet21

2.3. Kriteret24

2.4. Detyra25

3. Parashtrimi i pyetjeve dhe diskutimi 27

Pse është me rëndësi?..... 27

3.1. Si të vijmë deri te pyetjet efektive dhe diskutimi?.....28

3.2. Përgjigjja me shkrim e pyetjeve34

4. Informata kthyese 37

Pse është me rëndësi informata kthyese konstruktive? 37

4.1. Kur dhe si jepet informata kthyese 38

4.2. Llojet e informatave kthyese40

5. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë..... 43

Pse është me rëndësi?..... 43

5.1. Si të siguroni vetënotim kualitativ?..... 44

5.2. Notimi i ndërsjellë.....46

6. Planifikimi në bazë të refleksionit	47
Pse është me rëndësi?.....	47
6.1. Çka është refleksioni?.....	47
6.2. Refleksioni në bazë të dhënave të marra nga nxënësit	50
7. Informimi i prindërve	51
Çka është me rëndësi?.....	51
Si ti informoni prindërit?	51
8. Shtojca.....	53
8.1. Shfrytëzimi i Taksonomisë së Blumit në notim.....	53
8.2. Katalog i strategjive dhe teknikave për notim	56

HYRJJE

Kur janë në pyetje të arriturat e nxënësve, si në nivel shtetëror ashtu edhe në nivel të nxënësit si individ, pyetje kyçe është: Si duhet të jetë notimi që të ndikon pozitivisht në mësimnxënien e nxënësve dhe të arriturat e tyre? Arsimitarët e dinë se vënia e theksit në testime ose vetëm në vënie e notave nuk ndihmon dhe se ata më tepër janë orientuar nga grumbullimi i fakteve të cilat nga jashtë pothuajse nuk ndikojnë në përmirësimin e mësimit, si dhe në të mësuarit më kualitativ.

Hulumtimet e Blekit dhe Viliamit (Black & William)¹, të kryera para 15 viteve, kanë bërë revolucion në pikëpamjet për rëndësinë e notimit formativ, çka në shumë vende rezultoi me reforma në notim dhe vënie e theksit në “notim për mësim”, “notim autentik”, “notim i futur në mësim”. Refleksione të atyre lëvizjeve ka edhe në vendin tonë nëpërmjet ndryshimeve metodike në mësim të cilat rregullisht paraqesin ose kyçin notim formativ. Gjithashtu, kyçja e notimit me shkrim në mësimin klasor ishte në drejtim të notimit më të mirë formativ.

Programet *Mendo matematikisht dhe shkrim leximi fillestar*, të finansuara nga UNICEF dhe programet e reja nga matematika dhe shkencat natyrore “Programet e Kembrixhit”, mundësuan që të gjithë arsimtarët klasorë të kalojnë nëpër seri trajnimesh për realizimin e sukseshëm të tyre. Megjithatë, në këta trajnime theks më i madh ishte vënë në mënyrën e realizimit të tyre, metodave dhe teknikave të cilat do të përdoren, ndërsa më pak rëndësi i është kushtuar notimit.

Nga këtu edhe arsimtarët dhe bartësit e programeve dhe trajnimet (Byroja e zhvillimit të arsimit, Qendra maqedonase për arsim qytetar, UNICEF- i) kanë identifikuar nevoja për trajnim të më fokusuar të arsimatrëve klasorë për notim formativ.

Ky doracak është përkrahje plotësuese për arsimtarët që do të marrin pjesë në trajnimet për notimin formativ. Në të shkurtimisht janë dhënë bazat teorike të notimit formativ dhe kahjet për arsimtarët se si ta përmirësojnë praktikën e tyre të notimit në mësim.

Doracaku i ka pjesët vijuese: çka është notimi formativ, me paraqitje të teorive bashkëkoheore për mësim dhe notim; Parashtrimi i qëllimeve dhe rrezultatet e pritura / kriteret për sukses; Parashtrimi i pyetjeve dhe diskutim; Informata kthyese; Vetëvlerësimi

1 Black P., D. Wiliam (1998). Assessment and classroom learning. Assessment in Education, 5(1).

dhe vlerësimi i ndërsjelltë; Planifikimi në bazë të refleksionit; Informimi i prindërve. Në fund, në Shtojcën 1 është dhënë taksonomia Blumit – mënyra e shfrytëzimit të saj në të cilën janë dhënë nivelet e taksonomisë dhe për çdo nivel : shembuj me folje me të cilat definohen rezultatet, pyetjet e mundëshme të cilat mund të shfrytëzohen në mësim dhe mënyra me të cilat mund të bëhet notimi. Në shtojcën 2 është dhënë katalog me përshkrime të 40 strategjive dhe teknikave që mund të shfrytëzohen në notimin formativ dhe për çdo strategji/teknikë janë dhënë dobitë kyçe dhe kahjet si dhe shembujt për shfrytëzim.

Struktura e doracakut dhe të thënat në tekst janë dhënë në format të pyetjeve të cilat i parashtrajnë arsimtarët kur bëhet fjalë për notimin dhe përgjigjet si dhe kahjet në lidhje me këta pyetje.

Në këtë doracak nuk duhet të shikohet si në përmbledhje të reçetave, por si nxitje për ndryshim të filozofisë së mësimin në të cilën qëllim i vetëm i notimit nuk do të jetë që të matë dhe të tregojë cili nxënës sa ka mësuar por t'ju ndihmon arsimtarëve dhe nxënësve që në mënyrë më efektive ta organizojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien. Për ate:

- ▶ Mos i zbatoni udhëzimet dhe strategjitë në mënyrë mekanike, por gjithmonë mendoni se a do të ndikojnë ata për përmirësimin e mësimnxënies së nxënësve tuaj;
- ▶ Aftësoni strategjitë e diturive, përvojave tuaja si dhe kushteve në të cilat punoni. Mos i hudhni që më parë me paragjykim se ajo nuk është e mundur të realizohet në kushtet në të cilat punoni;
- ▶ Provoni, bëni në fillim ndryshime më të vogla dhe mësoni nga përvoja vetanake dhe nga përvoja e kolegëve në shkollën tuaj.

1 Çka është notimi formativ?

1.1. DEFINIMI DHE PËRDORIMI

Notimi është proces i grumbullimit të të dhënave dhe sjellja e gjykimit për të arrituar e nxënësve në raport me kriteret e caktuara për sukses.

Notimi i të arriturave të nxënësve është pjesë përbërse i procesit mësimor i cili duhet të ndikon për nxënësit që më së miri dhe më kualitativisht ta arrijnë (mësojnë) ate që është parashikuar me programet mësimore.

Nga kjo parashtrihen pyetjet: Si duhet të jetë notimi për t'ju ndihmuar nxënësve të mësojnë më shumë dhe më mirë? A i ndihmon nxënësit të mëson më shumë dhe më mirë vet njohuria për ate se çfarë note ka fituar?

Hulumtimet thonë se njohja e rezultatit nga mësimi në masë të konsideruar ndikon në motivimin për mësimnxënie por jo gjithmonë sjell deri në mësimnxënie më të mirë dhe në rezultatet më të larta.

Që të përmirësohet mësimnxënia, notimi duhet të jetë **formativ**.

Notimi formativ Ka të bën me “të gjitha aktivitetet e arsimarit dhe/ose të nxënësve që sigurojnë informatë se çka do të shfrytëzohet për tu përmirësuar mësimdhënia dhe mësimnxënia.

(Black & Wiliam, 1998)

Cilat janë karakteristikat e notimit formativ ?

- ♦ E para, mënyra se si shfrytëzohet. Informata e fituar nëpërmjet notimit për ate se deri ku është nxënësi në të arriturat e qëllimit të parashtruar, gjatë notimit formativ shfrytëzohet menjëherë për tu bërë riaftësime në mësim dhe ti jepen kahje nxënësit në mësimnxënie.
- ♦ Pastaj, mënyra në të cilën është kyçur në mësim. Notimi formativ është pjesë përbërëse e të gjitha fazave në mësim, nga planifikimi deri në refleksionin e arishtarit për suksesin e orës.

- ◆ E treta, kyçja e nxënësve. Notimi formativ nuk është proces të cilin e realizon vetëm arsimtari. Për të qenë notimi formativ, patjetër duhet të kyçen edhe nxënësit. Çdo nxënës duhet të ketë shfaqje të qartë se çka është ajo që duhet të arrihet, çka duhet të bëhet për ta arrit atë si dhe si do të tregon se ka mësuar.

Tre pyetje kyçe që e përcaktojnë notimin formativ

- ▶ Ku duhet të arrij?
- ▶ Ku jam tani?
- ▶ Çka duhet të bëj për ta realizuar qëllimin?

Këta pyetje i parashtrojnë edhe arsimtarët edhe nxënësit, ndërsa notimi i mirë formativ ju ndihmon që vazhdimisht të fitojnë përgjigje për ta.

NOTIMI FORMATIV NGA PERSPEKTIVA E:

Nxënësi	Arsimtari
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Dij çka duhet të mësoj/ të arrij 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ E di se deri ku janë tani nxënësit e mi dhe çka duhet të arrihet deri në fund të vitit / temës. ▶ I planifikoj qëllimet mësimore për tërë paralelen dhe për nxënës të caktuar. ▶ I njoftoj nxënësit më qëllimet dhe rezultatet e pritura nga mësimi.
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Dij se si të mësoj. ▶ Dij se është normale deri sa mësoj të bëj edhe gabime. ▶ Kur diçka nuk e kam të qartë, marr ndihmë nga arsimtari ose nga shokët. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Për çdo ditë e ndjeki mësimnxënien dhe përparimin e çdo nxënësi dhe i jap informatë kthyesë. ▶ Bisedoj me nxënësin / nxënësit për të kuptuar se si mendojnë dhe pse kanë bërë gabime të caktuara. Ju ndihmoj që ti kuptojnë dhe ti tejkalojnë vështirësitë në mësimnxënie. ▶ Organizoj aktivitete ku nxënësit mësojnë nga njëri tjetri dhe e vlerësojnë punën vetanake. ▶ Bëj përshtatjen e mësimin në kërkesat rrjedhëse të nxënësve.
<ul style="list-style-type: none"> ▶ E di sa kam mësuar. ▶ Mundem në mënyra të ndryshme që të dëshmoj se kam mësuar. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Kam kritere të qarta për të arriturat. Me ta i njoftoj nxënësit dhe prindërit. ▶ Shfrytëzoj instrumente të ndryshme për matjen e të arriturave.
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Mundem të planifikoj se çka duhet të mësoj në vijim. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Analizoj punën vetanake dhe të arriturat e nxënësve. Në bazë të këtyre njohurive i bëj planifikimet vijuese. ▶ Rregullisht i informoj prindërit për mësimnxënien dhe të arriturat e fëmijëve të tyre.

Në notimin formativ shfrytëzohen strategjitë kyçe vijuese:

Aktivitetet e arsimit dhe të nxënësve gjatë procesit mësimor nëpërmjet notimit formativ vazhdimisht gërshetohen. Qëllimin e kanë të njëjtë: si të gjejnë dhe të shfrytëzojnë strategji përkatëse për mësimdhënie dhe mësimnxënie që do të ndihmojnë që nga niveli ekzistues i tyre të arrijnë në nivelin më të lartë të planifikuar.

1. Parashtrimi i qëllimeve të qarta dhe rezultateve të pritura të cilat shkëmbehen me nxënësit;
2. Organizimi i diskutimit efektiv dhe parashtrimi i pyetjeve dhe detyrave nëpërmjet të cilave mund të shihet të kuptuarit e asaj që mësohet;
3. Dhënia e informatës kthyesë e cila do të përmirëson mësimnxënien;
4. Kyçja e nxënësve në notim (vetënotimi dhe notimi i ndërsjelltë) për shkak të mësimnxënies njëri nga tjetri;
5. Aftësimi i nxënësve që të marrin përgjegjësinë për mësimnxënien vetanake;
6. Planifikimi i mësimnxënies dhe mësimdhënies bazuar në refleksion.

Procesi i vazhdueshëm i parashtrimit të qëllimeve mësimore, vlerësimi i mësimnxënies dhe niveli rrjedhës i diturive dhe puna e planifikuar dhe sistematike (e nxënësve dhe e arsimit) për arritjen e qëllimeve, është thelbi i notimit formativ.

Vizatimi 1: *Cikli mësimor*

(marrur nga *Assessment for Learning, A practical Guide (2009)*)



1.2. SI NOTIMI FORMATIV E PËRMIRËSON TË MËSUARIT DHE TË ARRITURAT?

Teoritë bashkëkohore për mismdhënie dhe mësimnxënie përfshinë notimin si pjesë përbërëse nga procesi mësimorë që përmirëson mësimnxënien, dhe se me zhvillimin e metodikës së mësimdhënies ndryshon edhe notimi.

KONSTRUKTIVIZMI

Nxënësit janë ata që duhet ta “konstruktojnë” ta krijojnë diturinë e tyre. Ata duhet informatat e tyre të reja të cilat i fitojnë ti lidhin dhe ti ndërtojnë në të kuptuarit për botën të cilën e kanë. Gjatë kësaj sistemi i kuptimeve dhe i lidhjeve të cilën deri atëherë e kanë patur të parashtruar është e nevojshme të modifikohet, plotësohet, pasurohet. Sa që është më e madhe diskrepanca ndërmjet diturive ekzistuese të reja, aq më vështirë është që të integrohen në një sistem.

Arsimtari mund që ta rindërton të mësuarit nëse:

- ▶ *Vërteton paradituritë e nxënësve dhe nëse informatat e reja i adapton ashtu që të mos jenë shumë dhe të mos jenë të komplikuar për të mundur të lidhen me informata ekzistuese;*
- ▶ *I strukturon informatat që të mundën nxënësit më lehtë ti kuptojnë dhe të bëjnë lidhjen e tyre;*
- ▶ *Prezanton informatat në më shumë mënyra të cilat janë më të përafërta dhe në gjuhë të kuptueshme për nxënësit;*
- ▶ *Organizon aktivitete të llojeve të ndryshme për mësim të cilat ju japin mundësi nxënësve që ti shqyrtojnë informatat dhe ti shfrytëzojnë në mënyrë që është më e përshtatshme për ta;*
- ▶ *Lejon dhe i nxit nxënësit që të mësojnë njëri nga tjetri. Ata sqarojnë gjërat në mënyrën e tyre më të thjeshtë;*
- ▶ *Din se ku është nxënësi në mësimnxënie, çka ka kuptuar dhe çka i paraqet vështirësi;*
- ▶ *Ndjek procesin e të menduarit, zgjidhjes së problemit/ detyrës (nëpërmjet sqarimit të nxënësit, pyetjeve që i parashtron) dhe kur vëren mospërshtatje, i ndihmon nxënësit ta kupton se si ka ndodh gabimi.*
- ▶ *Nxit parashtrimin e pyetjeve nga nxënësit dhe nuk i nënvlerëson pyetjet (nuk ka pyetje qesharake);*
- ▶ *Tregon dhe diskuton shembuj me nxënësit për dituri të strukturuar mirë (përgjigje të pyetjes, zgjidhje të detyrës, punim i përgatitur);*
- ▶ *Lejon dhe nxit nxënësit që ta tregojnë diturinë e tyre në mënyrën më të përshtatshme për ta.*

Pjesa më e madhe e qasjeve të përmendura janë karakteristike për notimin formativ

METAKOGNITIVITETI

Nxënësit shfrytëzojnë procese të ndryshme të të menduarit si dhe strategji për të fitur dituri dhe të zgjidhin detyra të cilat ju parashtrihen dhe jo gjithherë janë të vetëdëshëm për ta. Hulumtimet thoë se ata të cilët janë të vetëdëshëm për ate se si mësojnë, si zgjidhin probleme si dhe si dituritë i zbatojnë në situata të reja, janë më të suksesshëm në mësimnxënie. Për ate vendohet theks në mësimnxënie të nxënësve se si të mësojnë, në realitet në përfitimin e diturive dhe shkathtësive metakognitive. Dituritë dhe shkathtësitë metakognitive kanë të bëjnë me:

- ◆ Dituritë për vehten si nxënës, anët e dobëta dhe të forta vetanake në mësimnxënie;
- ◆ Dituri për detyrën – njohuri për mënyrat e ndryshme për të mësuarit, dituri se si duhet të zgjidhet ndonjë detyrë;
- ◆ Dituri strategjike për ate se kur duhet të shfrytëzohen dituri të caktuara, si të planifikohet të mësuarit, çka duhet të bëhet kur do të përballeni me problem.

Aftësitë dhe shkathtësitë metakognitive mundësojnë planifikimin se si të mësohet, të zgjidhet ndonjë problem të mendohet për procesin e të mësuarit, të vlerësohet rezultati dhe në rast se është e nevojshme të modifikohet qasja. Ata që janë pajisur me shkathtësi metakognitive (mendojnë për të menduarit e tyre, mund të planifikojnë, kontrollojnë dhe vlerësojnë), mësojnë në mënyrë më efektive gjatë tërë jetës.

Arsimtari mund ta rindihmon zhvillimin e shkathtësive metakognitive nëse:

- ▶ *Parashtron pyetje të cilat i nxitin nxënësit që të menojnë dhe sqarojnë se si kanë arritur deri te përfundimet / zgjidhjet e caktuara, si mundet ndryshe ta zgjidhin detyrën;*
- ▶ *I përkrahin nxënësit “të mendojnë zëshëm“;*
- ▶ *I përkrahin të mësojnë nga gabimet vetanake;*
- ▶ *I mësojnë nxënësit të shfrytëzojnë harta mendore, organizatorë grafik, diagrame;*
- ▶ *Nxisin nxënësit të mendojnë se ku munden të zbatojnë mënyrë të caktuar të zgjidhjes së problemit;*
- ▶ *Nxit nxënësit të mendojnë se çka i ndihmon dhe çka i pengon në mësimnxënie;*
- ▶ *Nxit parashtrimin e qëllimeve dhe planifikimin e mësimnxënies; nxënësit vetëvlerësohen se çka dijnë mirë dhe çka nuk dijnë;*
- ▶ *Krijon situata, jep detyra të hapura në të cilat nxënësit vetë duhet të vendosin se cilat dituri procedurale dhe deklarative do ti shfrytëzojnë;*
- ▶ *Nxënësit notohen në mënyrë reciproke dhe bisedojnë për ate se si e kanë zgjidhur detyrën.*

Notimi formativ i kyç proceset metakognitive dhe ndikon për zhvillimin e shkathtësive metakognitive

ZONA E ZHVILLIMIT VIJUES DHE PËRKRAHJA NË MËSIM

Teoritë sociokulturore për të mësuarit i potencojnë njohuritë se fëmijët i zhvillojnë aftësitë kognitive dhe mësojnë nëpërmjet interaksionit me mjedisin dhe me njerëzit e tjerë. Shfrytëzimi i gjuhës dhe të mësuarit e rezonimit në situata të caktuara ka rol të rëndësishëm. Në situata të ndryshme të mësimit joformal jashtë shkollës dhe në mësimin formal në shkolla, fëmijët mësojnë me përkrahje nga të rriturit dhe fëmijët e tjerë të cilët ju mundësojnë që të kyçen në aktivitete, ju ndihmojnë ti tejkalojnë, ju ndihmojnë si modele. Përkrahja në procesin e përvetësimit të shkathtësive kognitive, si dhe në përvetësimin e shkathtësive fizike është mjaftë me rëndësi për përfitimin e cilado kompetencave. Me rëndësi të veçantë është që përkrahja të zhvillohet në “fazat e zhvillimit vijues” (Vigotski). Ajo është faza në zhvillimin fizik ose kognitiv kur fëmiju “është i pjekur” që ti tejkalon gjërat, por ende nuk i ka përvetësuar dhe se të gjitha gjërat do të mund të bëhen në rast se fiton përkrahje nga dikush me më përvojë. Si psh. fëmiju i cili fillon të ecë mjafton që vetëm pak të mbahet për gishtin e të rriturit, nxënësi i cili ka probleme me operacionet matematikore, shfrytëzimi i mjeteve konkrete ndihmon ta zgjedh detyrën. Të mësuarit zhvillohet në fazën e zhvillimit vijues. Nëse insitojmë që nxënësi të mëson diçka për të cilën nuk është i përgatitur, si psh, të mbledh para se të formon kuptimin për numrin, aktivitetin mund ta mëson mekanikisht, a në rast se i japim aktivitete që veç më i ka përvetësuar, në realitet ai nuk mëson asgjë të re. Ndjekja e suksesshme e të menduarit të nxënësit dhe mënyra se si i zgjidh detyrat është kyçe për arsimtarin që të cakton se çfarë lloj detyre dhe cili lloj i përkrahjes është më adukuate në mësim. Kur arsimtari shfrytëzon notimin formativ, ai do të thëllon të kuptuarit te nxënësi dhe do ta ndihmon përvetësimi e diturive në rast se:

- ▶ *I kontrollon paradituritë dhe në ta rindërton aktivitetet e reja;*
- ▶ *I strukturon aktivitetet hap pas hapi dhe ndjek përvetësimin;*
- ▶ *Ju ndihmon nxënësve që të parashtrojnë qëllime mësimore përkatëse;*
- ▶ *Kyç nxënësit në notimin e ndërsjelltë dhe vetëvlerësim;*
- ▶ *Parashtron nënpyetje;*
- ▶ *Jep informatë kthyesë në të cilën gabimi shihet si hap në të mësuarit ;*
- ▶ *Në kriteret për notim dhe në informatën kthyesë shfrytëzon kategorinë “ende nuk...”;*
- ▶ *Ju sqaron nxënësve kriteret për notim për ta ditur se çka saktë pritet nga ta;*
- ▶ *Gjatë dhënies së informatës kthyesë, ju jep edhe kahje për punën e metutjeshme.*

PËRKRAHJA NË MËSIM DHE NOTIMI FORMATIV JANË STRATEGJI TË CILAT ARSIMITARËT I SHFRYTËZOJNË PËR TA LËVIZUR TË MËSUARIT TË ZHVILLOHET NË FAZËN E ZHVILLIMIT VIJUES.

(Lori Shepart)

KORNIZAT E TË MENDUARIT

Të besuarit e nxënësve për aftësitë vetanake dhe mundësia që ata të përmirësohen me ushtrime, në masë të madhe cakton raportin ndaj të mësuarit. Sipas teorisë së karol dweck dhe të tjerë. (Carol s. Dweck, gregory m. Walton, & geoffrey l. Cohen, academic tenacity: mindsets and skills that promote long-term learning) dallohen dy lloje të kornizave mendore: fikse dhe zhvillimore.

NXËNËSIT ME KORNIZA FIKSE TË TË MENDUARIT ...	NXËNËSIT ME KORNIZA ZHVILLIMORE TË TË MENDUARIT ...
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Besojnë se aftësitë për të mësuar janë të lindura dhe nuk mund që të arrihet më shumë sa e sa që të mundohen. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Besojnë se mund të arrijnë sukses në rast se japin më tepër mund.
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mendojnë se puna e mundimshme është tregues se nuk janë mjaft të aftë. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Besojnë se me punë të mundimshme mund ti përmirësojnë aftësitë e tyre.
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Janë të fokusuar në nota, vazhdimisht krahasohen me të tjerët dhe janë jo të lumtur nëse nuk janë më të mirë. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Janë të fokusuar në mësim, krahasohen me vetveten dhe gjejnë kënaqësi në përparimin vetanak.
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mossuksesin e konsiderojnë për tregues se nuk janë të aftë, ajo i demotivon dhe heqin dorë nga detyrat më të vështira. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Gabimet i kuptojnë si normale gjatë të mësuarit, ndërsa mossuksesi mund të tejkalohet në rast se jepet më tepër mund. ◆ Janë këmbëngulës dhe nuk dorëzohen lehtë nga detyrat.
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Me rëndësi është që ti lëvdojnë se sa janë të mençur dhe ndjehen keq në rast se të tjerët nuk mendojnë ashtu për ta. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Me rëndësi është që tjerët ta vërejnë punën e tyre dhe kjo i motivon për punë.

Korniza e të menduarit formohet dhe ndryshon nën ndikimin e përvojës. Njëra nga periudhat kyçe në zhvillim është rreth vjetit të shtatë kur fëmijët fillojnë që aftësinë ta kuptojnë si karakterisitkë personale dhe e caktojnë nëpërmjet krahasimit me të tjerët. Për ate periudha e mësimit klasorë në të cilën nxënësit fitojnë përvojat e hershme në mësim është më rëndësi të veçantë për formimin e kornizës zhvillimore të të menduarit ku secili nxënës do të beson se mund t'ia arrin qëllimit dhe do të jap mund në përmirësimin e të mësuarit.

Arsimtari mund ta rindihmon ate nëse:

- ▶ *Nxënësit i lëvdon për mundin e dhënë dhe jo për aftësitë;*
- ▶ *Shfrytëzon shembuj nga njerëzit të tjerë të cilët kanë arritur sukses në punë dhe me mund;*
- ▶ *Nxit metakognitivitet (të menduarit për procesin e të mësuarit), jep komente për procesin e të mësuarit, jo vetëm për të arriturat, jep kahje për më tutje;*
- ▶ *Gabimet i pranon si pjesë e mësimin – nuk noton në bazë të numrit të gabimeve, por në bazë të standardeve që më parë të parashtruara;*
- ▶ *Mundëson mënyra të ndryshme për tejkalimin e gabimeve;*
- ▶ *Nxënësit nuk i krahason njëri me tjetrin, por në raport me përparimin vetanak;*
- ▶ *Nxit të mësuarit njëri nga tjetri;*
- ▶ *Mundëson që të mësuarit të tregohet në mënyra të ndryshme.*

Të gjitha këta qasje janë karakteristike për notimin e mirë formativ.

2 Parashtrimi i qëllimeve dhe rezultatet e pritura/kriteret për sukses

Nga nxënësi duhet të “nxjerrim” ate që e din më së miri dhe mund (në ate që është i mirë) edhe ate ta notojmë.

Të arrituarit e nxënësit në mësim në masë më të madhe është shprehja e punës së arsimit.

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Notimi formativ paraqet pjesën përbërëse të procesit mësimorë, në realitet kjo zhvillohet gjatë tërë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë kësaj ekziston lidhje e qartë ndërmjet qëllimeve mësimore, përmbajtjes së mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe notimit.

Nga qëllimet mësimore dhe përmbajtjet varet se çka do të notohet, ndërsa nga rezultatet varet se si do të zhvillohet mësimi, nga cilat qëllime do të pretendojmë dhe çka nga nxënësit pritet që të tregojnë si rezultat i të mësuarit.

Dituritë kanë katër dimensionet edhe ato:

DITURITË FAKTIKE - elementet bazike të cilat nxënësit duhet që ti dijnë për tu njohur me disiplinë të caktuar ose të zgjidhin problem. Përfshinë: njohjen e terminologjisë, termet shkencore, simbolet, shenjat; njohja e detajeve dhe elementeve specifike.

DITURITË KONCEPTUALE - përfshinë: njohja e klasifikimeve, kategoritë dhe titujt; njohja e parimeve dhe gjeneralizimi; njohja e teorive, modeleve dhe strukturave.

DITURITË PROCEDURALE - si të bëhet diçka specifike në korniza të lëndës, metodat e hulumtimit. Përfshinë: njohja e shkathtësive specifike, teknika dhe algoritme për lëndën e caktuar; njohja e kriterëve për zgjedhje dhe shfrytëzim të procedurave përkatëse, shkathtësitë, teknikat dhe metodat.

DITURITË METAKOGNITIVE – dituri për të menduarit, vetëdije dhe të kuptuarit e proceseve vetanake kognitive. Përfshinë: dituri strategjike (strategji bazike dhe metoda për të mësuarit, të menduarit dhe zgjidhjen e problemeve); dituri për detyrat kognitive – cilat strategji dhe si të shfrytëzohen për cilat detyra; dituritë kontekstuale; dituri për vehten.

ÇKA JANË QËLLIMET ARSIMORE, REZULTATET E TË MËSUARIT DHE DETYRAT?

Shkalla e të arriturave vlerësohet nëpër 4 faza të cilat e formojnë notimin formativ:

Parashtrimi i qëllimeve dhe rezultateve – ate që presin ta arrijnë nxënësit në pajtim me programet mësimore dhe karakteristikat individuale të nxënësve.

Mbledhja sistematike e të dhënave gjatë procesit të mësuarit për shkallën e arritur të kompetencave: dituri, shkathtësi, pavarësi dhe përgjegjësi ndaj punës, ballafaqim (dhe shënim) të shkallës së arritjes së kompetencave.

Vlerësimi i shkallës së arritjes së kompetencave dhe **dhënia e informatës kthyesë**.

Marrja e aksionit nga ana e arsimtarit dhe nxënësve e cila do të shpien deri te rezultatet e pritura.

QËLLIMET ARSIMORE ose **QËLLIMET MËSIMORE** përshkruajnë se çka dëshiron arsimtari të bën për të mundur nxënësit pas një periudhe të caktuar të të mësuarit ta dijnë ate që më parë nuk e kanë ditur.

REZULTATET E TË MËSUARIT definojnë atë që nxënësi duhet ta dijë ta bën në fund të periudhës të caktuar të të mësuarit.

DETYRA është aktivitet i lidhur me përmbajtjet mësimore të cilat nxënësi i përvetëson gjatë kohës së mësimin ose punës së pavarur deri në ate shkallë që është caktuar me rezultatet e mësimin gjatë së cilës rezultati mund të matet dhe të notohet sipas kriterit të caktuar.

2.1. QËLLIMET

Qëllimet janë të orinetuara nga puna e bërë e nxënësit dhe sukcesi i tij. Ata shprehin rezultatin e dëshiruar të procesit edukativo – arsimorë dhe duhet të caktohen në mënyrë precize dhe reale. Ata:

- ▶ Sigurojnë kahje për mësimin,
- ▶ I informojnë të tjerët për qëllimet e mësimin,
- ▶ Sigurojnë baza për notim të të arriturave.

Qëllimet e përgjithshme mësimore:

- ◆ Janë të pritura të përgjithshme për atë se çka duhet nxënësi të realizon në korniza të lëndës mësimore të caktuar;
- ◆ Janë gjykime që më globalisht përshkruajnë se çka do të fiton nxënësi nga mësimdhënia;
- ◆ Janë të defnuara në programet mësimore;
- ◆ Vështirë maten;
- ◆ Janë afatgjate – relaizohen me të arriturat e të gjitha qëllimeve të veçanta.

Qëllimet mësimore të veçanta (specifike):

- ◆ Janë gjykime të cilat përshkruajnë të arriturat e arsimtarit për atë se çka duhet nxënësi të mëson;
- ◆ Janë pohime të shkurta dhe të qarta për dituritë konkrete, shkathtësi dhe komptenca të cilat i presim nga nxënësi;
- ◆ Dalin nga qëllimet mësimore të përgjithshme dhe i konkretizojnë;
- ◆ Udhëheqin arsimtarin nga ajo që duhet të punon me nxënësit;
- ◆ Janë defnuar në planifikimet e arsimtarëve;
- ◆ Duhet të defnohen në nivel të proceseve kognitive dhe llojeve të diturive.

2.2. REZULTATET

Rezultatet nuk janë:

- ▶ Pohime me të cilat numërohen ose përshkruhen përmbajtjet mësimore;
- ▶ Pojime me të cilat tregohet se çka duhet arsimtarët të bëjnë;
- ▶ Parafrazimi i qëllimeve.

Rezultatet janë pohime të treguara qartë të shënuara nga ana e arsimtarit për atë se çka pritet nga nxënësi të dijë të kupton dhe të jetë i aftë të tregon pas mbarimit të procesit mësimor.

(Vlasta Vizek Vidović: *Ishodi učenja u obrazovanju učitelja i nastavnika – konceptualni okvir*, Zagreb 2008.). Ata:


- ◆ Dalin nga qëllimet e veçanta mësimore,
- ◆ Defnohen nëpërmjet dhënies së aktiviteteve konkrete,
- ◆ Mundet në mënyrë direkte të observohen dhe të maten,
- ◆ udhëheqin arsimtarin në përgatitjen e instrumenteve në përkthim

Rezultate janë:

- ▶ pohime për atë se çka pritet nga nxënësit të bëjnë si rezultat i të mësuarit,
- ▶ pohime të cilat përshkruajnë se si nxënësit demonstrojnë atë që kanë mësuar (çka dijnë dhe/ose çka mund të bëjnë),
- ▶ të drejtuara nga nxënësit dhe aktivitetet e tyre dhe për atë gjithmonë tregohen me **foljet aktive** që shprehin aktivitetin e nxënësve.

CAKTIMI I REZULTATEVE

Vizatimi 2. Raporti i qëllimeve të përgjithshme, qëllimet specifike, rezultatet



Rezultatet e pritura i formulojnë arsimtarët, por njohja e tyre është e rëndësishme edhe për nxënësit edhe për prindërit.

Rezultatet ju mundësojnë:

Me arritjen e rezultateve të planifikuara në mësim, nxënësi tregon se ka fituar ndonjë kompetencë.

Me rëndësi është që nxënësit të njoftohen me ate se çka pritët nga ata.

NXËNËSVE	ARSIMTARËVE	PRINDËRVE
<p>T'ju jepen përgjigje në pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ çka pritët nga unë? ◆ çka duhet të dijë (të mësoj)? ◆ çka duhet të di të bëj? ◆ Si duhet të sillem? ◆ në cilën mënyrë do të arrij më së shumti? 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Ti planifikojnë përmbajtjet, strategjitë mësimore dhe metodat e mësimdhënies të cilat do ti zbatojnë. ◆ Saktë të definojnë se çka duhet nxënësit të dijnë të bëjnë në fund të procesit mësimorë. ◆ Ti planifikojnë vlerësimet e të arriturave të nxënësve. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Të fitojnë çfaqje për ate se me çar lloj të diturive, shkathësive dhe vlerave do të fitojnë fëmijët nëpër procesin mësimorë. ◆ Të mundet ta ndjekin përparimin e fëmiut të vetë dhe ti ndihmojnë.

REZULTATET SI KORNIZË **PËR PLANIFIKIM DHE VLERËSIM**

Rezultatet janë pikë fillimi për programim, në realitet për planifikim të përmbajtjeve dhe aktiviteteve mësimore. Njëkohësisht, ata janë kornizë për vlerësimin e të arriturave. Domethënë, ata i shfrytëzojnë kur planifikojmë mësimin dhe kur vlerësojmë.

Për ate, me rëndësi të veçantë është që rezultatet e mëimit, mirë të zgjedhen dhe të formulohen drejtë, ndërsa ndjekja dhe informata kthyesë të jenë në korniza të rezultateve të definuara të mëimit.

Rezultatet duhet që të përcillen me kritere përkatëse për vlerësim sipas të cilave mund të caktohet se a janë ata të realizueshme.

SI TË SHËNOHEN REZULTATET?

Gjatë shënimit të rezultateve të të shënuarit shfrytëzohen folje aktive precize nga lista e foljeve sipas taksonomisë së Blumit.

- ◆ Duhet të nisët nga qëllimet, çka është ajo që nxënësi në fund të një cikli mësimorë duhet ta dinë dhe të mundet ta bën.
- ◆ Çdo rezultat duhet të jetë i përshkruar me folje aktive (*nxënësi do të mundet të përshkruan...krahason...demonstron...bën diagrame...prezanton...arsyeton...*).
- ◆ Duhet të anashkalohen foljet joprecize dhe të pamatshme (*të aftësohet, të njihet me, të jetë i vetëdijshëm, të mëson, të kupton, të përvetëson...*). Ata kryesisht shrytëzohen për definimin e qëllimeve.
- ◆ Rezultatet duhet ti përfshijnë të gjitha elementet e kompetencave: fushat e diturive, mundësitë dhe vlerat.
- ◆ Rezultati duhet të jetë i arritshëm dhe i matshëm.

SHEMBULL I REZULTATIT

I CILI VËSHTIRË MATET:

Nxënësi të dijë për fjalinë e thjeshtë dhe të zgjeruar

SHEMBULL NGA REZULTATI I FORMULUAR MIRË:

DITURI	<i>Të defnion fjali të zgjeruar.</i>
TË KUPTUARIT	<i>Ta njeh fjalinë e thjeshtë dhe të zgjeruar në mesin e fjalive të shënuara.</i>
ZBATIMI	<i>Ta shndëron fjalinë e thjeshtë në fjali të zgjeruar.</i>
ANALIZA	<i>Të formulon rregull për shndërimin e fjalisë së thjeshtë në fjali të zgjeruar.</i>
SINTEZA	<i>Të formulon rregull për shndërimin e fjalisë së thjeshtë në fjali të zgjeruar.</i>
EVALUIMI	<i>Ti krahason të dy procedurat për shndërimin e fjalisë së thjeshtë në fjali të zgjeruar, ta zgjedh procedurën më të mirë dhe ta arsyeton zgjedhjen.</i>

Kur prindërit dhe nxënësit do ti njoftoni me rezultatet e pritura, shfrytëzoni gjuhë më të thjeshtë të cilën ata do të mundën ta kuptojnë. Nxënësit shpesh nuk bëjnë dallime ndërmjet detyrës dhe rezultatit. Ndihmoni ata që ta kuptojnë se çka do të mësojnë nëpërmjet zgjedhjes së detyrave.

2.3. KRITERET

Kriteret në realitet dalin nga rezultatet.

Rezultatet e të mësuarit shpiejnë nga kriteret sipas të cilave do të bëhet notimi.

Kriteret për notim të suksesit të nxënësit në lëndë mësimore përkatëse caktohet: lloji, vëllimi dhe niveli i diturive të përvetësuara, aftësitë dhe shkathtësitë në raport me atë se çka është shënuar me programet mësimore për atë lëndë dhe klasë.

Niveli i diturive, aftësive dhe shkathtësive caktohet varësisht nga kualiteti i përmbajtjeve të përvetësuara: komplikueshmëria e diturive të përvetësuara, aftësitë dhe shkathtësitë, shkalla e të kuptuarit të


përmbajtjeve të përvetësuara dhe aftësimi për zbatimin e tyre.

Kriteret fitohen me zberthim të rezultateve, shkallëzimi i tyre në bazë të nivelit të të arriturave dhe vendosja në grupe të niveleve / pikave/ të notave.

2.4. DETYRA

Detyrat i mendojnë arsimitarët në formë të pohimeve të caktuara saktë, të cilat janë konkrete dhe e përshkruajnë aktivitetin të cilin do ta realizon nxënësi për të arritur deri te qëllimi. Në realitet, detyrat janë hapat nëpër procesin e të mësuarit nëpërmjet realizimit të të cilit nxënësi do të vjen deri te ajo që e presim ta demonstroi si dituri, aftësi ose shkathtësi.

Vizatimi 3. *Raporti i qëllimit, detyrës, rezulttit*



3 Parashtrimi i pyetjeve dhe diskutimi

Të mësuarit në realitet është kërkesa e përgjigjeve të pyetjeve. Pyetjet në mësimin e përditshëm i parashtrijmë vetë, ndërsa në shkollë pyetjet shpesh i parashtron arsimtari, përmbahen në libër ose i parashtrijmë nxënësit tjerë – diskutojmë ndërmjet veti.

Pyetje kyçe në lidhje me pyetjet:

- ▶ Si të sigurojmë që të gjithë nxënësit të jenë aktiv?
- ▶ Çfarë pyetje duhet të parashtrijmë që ta thellojmë diturinë e nxënësve?

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Nëpërmjet kërkimit të përgjigjeve të pyetjeve, nxënësit i plotësojnë skemat e të menduarit të tyre, formojë kuptime dhe bëjnë lidhshmëri të diturive (shiko konstruktivizmin). Duke i'u përgjigjur pyetjeve ose duke sqaruar kuptimet dhe proceset nxënësve tjerë, ata sistematizojnë dituritë. Nga kjo, pyetjet dhe diskutimet janë mënyra më e mirë që të caktohen të gjitha llojet e diturive: faktike, procedurale, konceptuale, metakognitive.

Parashtrimi i paramenduar i pyetjeve:

- ◆ ju mundëson nxënësve që ta kontrollojnë dhe ta thellojnë diturinë dhe ta bëjnë më të qëndrueshme;
- ◆ I orienton nxënësit nga gjërat kyçe që i mësojnë;
- ◆ I mundëson arsimtarit të fiton qasje në vëllimin dhe thellësin e diturive të nxënësve, ti zbulon lëshimet në dituri dhe gabimet në të kuptuar, a kjo është baza për orinetimin në punën e mëtutjeshme të nxënësit të cilën arsimtari duhet t'ia siguron ;
- ◆ Arsimtarit i siguron informata për diturinë, të kuptuarit, për shkathtësinë me të cilat është furnizuar nxënësi, që është baza për planifikimin e mësimin, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe metodik.

E gjithë kjo ndikon që nxënësit nga shkalla e diturive ku gjenden tani, të ngjiten në shkallën vijuese të cilën e dëshirojnë.

3.1. SI TË VIJMË DERI TE PYETJET EFEKTIVE DHE DISKUTIMI?

PYETJET KYÇE DUHET

PARAPRAKISHT TË PLANIFIKOHEN

Më tepër mund duhet të jepet në formulimin e pyetjeve që vlen të parashtrihen, në rielitet pyetje që do të sjellin deri te dituritë të cilat janë thelbësore për të kuptuarit e asaj që mësohet.

(Paul Black et al. 2003)

Parashtrimi i pyetjeve në masë të madhe është diktuar nga situata mësimore dhe përgjigjet e nxënësve. Por, pyetjet kyçe për ndonjë përmbajtje të caktuar është mirë që parapraakisht ti planifikoni. Në këte do tju ndihmojnë rezultatet e pritura nga të mësuarit të cilat i keni planifikuar që më parë.

- ▶ Mendoni/shënoni se në cilat pyetje dëshironi që nxënësit të mundën të përgjigjen në fund të orës/aktivitetit. Shënoni vetëm pyetjet më të rëndësishme.
- ▶ Keni kujdes për ndërlikueshmërinë e tyre në pyetje. Mund ti rradhitni, për shembull në bazë të taksonomisë së Blumit (shiko Shtojcën 1).
- ▶ Mund ti parashtroni në fillim të orës si rezultate të pritura (për shembull: *Pasi që ta mësojmë këtë, do të dini (mund të përgjigjeni): Si..., Pse...*). Në Fund do të riktheheni të kontrolloni se a mundet nxënësit me të vërtetë t'ju përgjigjen pyetjeve.
- ▶ Mund ti parashtroni në ndonjë pjesë të aktivitetit ose në fund. Mund të kërkonti të përgjigjen me shkrim ose gojarisht. Në këtë mënyrë do të kontrolloni se në çfarë mase i kanë arritur rezultatet që i keni pritur.
- ▶ Mos parashtroni shumë pyetje të këtilla për shkak se nuk do të ketë kohë për t'ju përgjigjur.

NXITNI NXËNËSIT QË TË PARASHTROJNË PYETJE

Hulumtimet tregojnë se kur nxënësit janë mësuar të parashtrojnë pyetje nxitëse dhe tentojnë të përgjigjen në ta, atëherë arrijnë rezultate më të larta në krahasim me nxënësit të cilët janë mësuar të shfrytëzojnë teknika tjera për mësim.

(Black & Villiam, 1998)

Mësoni nxënësit deri sa mësojnë (në orë ose nga libri) të parashtrojnë pyetje në lidhje me përmbajtjen për ta kuptuar më mirë, ta zgjerojnë, ta bëjnë lidhjen me dituritë tjera. Aftësia për të kuptuarit përmirësohet nëse të mësuarit kyç: parashikime, parashtrim të pyetjeve, përgjigje të tyre dhe sqarime.

Mund ti shfrytëzoni strategjitë vijuese:

- ▶ Nxënësit le të shkruajnë nga tre (ose më tepër) pyetje për përmbajtjen përkatëse. Pastaj do ti lexojnë para të gjithëve, në grup ose ju do ti kontrolloni. Mundet ju të zgjedhni ose çdo nxënës të zgjedh pyetje të cilës do ti përgjigjet.
- ▶ Le ti shkruajnë pyetjet nga të cilat duhet të fitojnë përgjigje dhe le ti vendosin në kutinë për pyetje.
- ▶ Mundet më vonë ti shfrytëzoni së bashku me nxënësit, ti vlerësoni (a janë të parashtruara mirë), ti klasifikoni (për shembull sipas asaj se si mundet të arrihet deri të përgjigja e pyetjes – dikund të lexojë; të hulumtojë, të mendojë), ia jepni ndonjë nxënësi tjetër të përgjigjet.
- ▶ Nxitni nxënësit ti shënojnë pyetjet të cilat “ju paraqiten “ deri sa mësojnë nga libri ose nëpërmjet ndonjë aktiviteti tjetër (për shembull ditar me shënime të dyfishta). Pastaj le të kontrollojnë se deri në fund të përmbajtjes / aktivitetit kanë fituar përgjigjen e tyre.
- ▶ Në fund të njësisë mësimore/aktivitetit nxënësit në çifte le të parashtrojnë pyetje dhe le të përgjigjen në ta (mendo, përgjigju në çift, shpërndaj).
- ▶ Zhvilloni diskutim në të cilin nxënësit njëri tjetrit do ti parashtrojnë pyetje me të cilat do të kërkojnë sqarime, argumentim të mendimeve të thëna.

Pyetjet e nxënësve janë nxitje e mirë për “kundër pyetje” nga lloji: *Çka mendon ti? Si tu kujtua që të pyesësh? Pse të intereson ajo?*, të cilat ndihmojnë për zhvillimin e metakognitivitetit.

Pyetjet e nxënësve janë tregues i mirë për atë se deri ku është nxënësi në mësimnxënie (çka ka kuptuar, e çka jo) dhe çka e intereson. Kjo i ndihmon në diferencimin e aktiviteteve vijuese.

PARASHTRONI PYETJE TË HAPURA

Pyetjet e hapura nxisin procese mendore më të zgjeruara (supozim, analizë, vlerësim, zgjidhje problemi) dhe kërkojnë përgjigje më të arsyetuara.

Pyetjet e mbyllura kërkojnë përgjigje të shkurtëra “të sakta” dhe i nxisin proceset mendore më të thjeshta siç është memorimi, rikujtimi.

(Brooks, 2002)

Koha në mësim është e vlefshme dhe prandaj kur është në pyetje lloji i pyetjes, nuk është shfrytëzuar koha në mënyrë produktive e cila është shpenzuar për parashtrim individual të pyetjeve të mbyllura. Me pyetjet e mbyllura më së shpeshti kontrolloni njohjen e fakteve, ata nuk provokojnë diskutim, ndërsa ju nuk mundeni të kontrolloni të kuptuarit. Për atë më së miri është pyetjet e këtilla ti jepni në formë të kuizit, ndërsa nxënësit me shkrim të shënojnë përgjigjen e cila duhet të jetë e shkurtë dhe konkrete.

Për kontrollimin e të kuptuarit, rezonimit dhe proceseve mendore të tjera më të larta, shfrytëzoni pyetje të hapura.

- ▶ Pyetjet e hapura japin mundësi për parashtrimin e pyetjeve tjera që mundësojnë të kontrollohet të kuptuarit (për shembull: *Pse mendon ashtu? Me çka mundesh ta vërtetosh ate? Çfarë lidhje ka ajo me...? Çka do të ndodh nëse...?*).
- ▶ Pyetjet e hapura i mundësojnë nxënësi të përgjigjet në nivel vetanak dhe gjatë kësaj mos ndjehet keq për shkak se përgjigja nuk është e saktë.
- ▶ Parashtroni pyetje të hapura që kërkojnë sqarime plotësuese. Në atë mënyrë do ta thelloni diturinë e nxënësve (si për shembull: *Çka mundesh tjetër të tregosh për...?*).
- ▶ „Modifikoni” pyetjet e mbyllura për të fituar pyetje të hapura. Si për shembull: *Sa është $7 + 8$? Këtheni pyetjen në: Me mbledhjen e cilave numra nga 1 deri 10 mund të fitoni numrin 15? Gjeni më tepër shembuj. Ose në vend: A është bredhi dru gjithëmbajtës? Pyetni: Pse bredhi është shembull për drunjët gjithëmbajtës?*

LERËNI KOHË NXËNËSVE

PËR TË MENDUAR

Pyetjet e arsimtarëve “shpesh janë joproductive” për shkak se “arsimtarët nuk presin gjatë kohë që të munden nxënësit të mendojnë për përgjigjen”

(Black & Viliam, 1998)

Hulumtimet kanë treguar se arsimtarët presin 1 – 3 sekonda pasi që të parashtrorin pyetjen, deri sa nuk thërasin nxënës që të përgjigjet. Kjo kohë nuk mjafton.

Nxënësit nuk janë kompjuterë dhe menjëherë ta japin përgjigjen e pyetjes të cilën e keni parashtruar. Atyre ju duhet kohë që të mendojnë, sidomos nëse pyetja kërkon aktivizim të proceseve më të zgjeruara mendore dhe nuk mund të përgjigjet vetëm në bazë të mbajturit mend.

„Mosdurimi” i arsimtarit shpjen deri në parashtrimin e pyetjeve që anagazhojnë nivele më të ulëta të të menduarit, a me të edhe të të mësuarit.

- ▶ Tregoni nxënësve se do t’ju parashtroni pyetje më të zgjeruar dhe do të kenë kohë për të menduar. Parashtroni pyetjen të gjithë nxënësve dhe jepni të paktën 10 sekonda për të menduar. Nëse pyetja kërkon përgjigje më të zgjeruar, jepni më tepër kohë dhe mundësi që ti shkruajnë “çështjet kyçe” të përgjigjes.
- ▶ Shmanguni pyetjeve të njëpasnjëshme. Shtrydhni përgjigjen e njëres pyetje para se ta parashtroni tjetrën. Disa nxënës shprehen më ngadalë, mos i shpejtoni, leni që të shprehin mendimin e tyre. Eventualisht jepni ndihmë me pyetje plotësuese.
- ▶ Kyçni sinjale për marrje të shpejtë të përgjigjes nga të gjithë nxënësit. Si për shembull “semafor” me kartela me ngjyra, “gishti i madh lartë/ poshtë” për të shprehurit e pëlqimit.

- ▶ Parashtroni pyetje që do të përgjigjen në dyshe, do të diskutojnë për përgjigjen dhe pastaj do të votojnë për përgjigje më të mirë të fituar nga dyshet/grupet.

KYÇNI TË GJITHË **NXËNËSIT NË DISKUTIM**

Shfytëzimi i nxënësve si resurse për mësim njëri nga tjetri mundëson përfitime për përparimin në mësim të të gjithëve.

(Slavin, Hurley and Chamberlain 2003)

Diskutimi me nxënësit dhe ndërmjet nxënësve mund ti tregojnë arsimtarit shumë për dituritë dhe të kuptuarit e tyre. Pyetjet e hapura janë nxitja më e mirë për diskutim. Qëllimi i diskutimit nuk është vetëm që të kontrollohet dituria, por të zgjerohet dhe të thellohet.

- ▶ Pyetjet parashtroni të gjithë nxënësve, ndërsa pastaj thirni ndonjë nxënës që të përgjigjet. Në këtë mënyrë do ti nxitni të gjithë të mendojnë. Pyetjet plotësuese gjithashtu duhet të parashtrohen për të gjithë (për shembull: *A mendojnë edhe të tjerët ashtu? A ka dikush ide se çka mund të thuhet ende për këtë?*)
- ▶ Kyçni rregull: pa e ngritur dorën. Ashtu do ta zvogëloni atmosferën garuese në klasë. Nxënësit jo të sigurtë do të ndjehen më mirë, nxënësit më të ngadalshëm nuk do të jenë të frustuar se nuk ju është kujtuar menjëherë përgjigja.
- ▶ Organizoni aktivitete në të cilat nxënësit diskutojnë bashkërisht për ndonjë problem. Shfrytëzoni ndonjë nga strategjitë në të cilën çdo njëri nga grupi parashtron dhe “mbron” ndonjë pozicion të caktuar (për shembull: 6 kapelat). Në atë mënyrë të gjithë do të kyçen.

REAGONI NË MËNYRË KONSTRUKTIVE **NË ÇDO PËRGJIGJE**

Gabimet janë pjesë e procesit mësimor.

Notimi formativ ka për qëllim që ta përmirëson të mësuarit në atë kontekst qëllimin e njejtë e ka edhe parashtrimi i pyetjes dhe nxitja e diskutimit me nxënësit dhe ndërmjet nxënësve.

Përgjigjet e pjesës më të madhe të pyetjeve nuk do të jenë të sakta, do të tregojnë lëshime dhe të kuptuarit të jo mjaftueshëm të koncepteve, procedurave dhe mospërvetësisimit të operacioneve më të komplikuar. Kjo është normale në procesin e të mësuarit. Mundohuni që edhe nxënësit ashtu ti pranojnë gabimet. Të vetat dhe të nxënësve të tjerë.

Parashtrimi i pyetjeve nuk guxon që të shndërohet në aktivitet stresi.

- ▶ Mos i komentoni negativisht përgjigjet e gabuara, por parashtroni pyetje plotësuese me çka do ti shpërbleni për përgjigjen e gabuar dhe do ti ndihmoni nxënësit që ta sqaron përgjigjen, me çka do ti ndihmoni që vetë ti sqaron gjërat (si psh: Si erdhe në këtë përgjigje? Fillo nga..., Si ishte...? (rikujtoni në diçka), parafrazoni përgjigjen e tij (si psh: Dëshiron të thuash...?).
- ▶ Parashtroni pyetjet në mënyrë tjetër (më thjeshtë), me fjalë tjera, ndoshta nxënësi nuk e ka kuptuar mirë pyetjen (si psh: Hajde më trego... të të pyes kështu ...). Thjeshtësoni nivelin e komplikueshmërisë së kërkesës. Për tu përgjigjur në pyetjet të cilat kërkojnë procese më të zgjeruara mendore (si psh. zbatimi, analiza), nxënësit në fillim duhet ti tejkalojnë problemet më të thjeshta (njohje, të kuptuarit).
- ▶ Nëse ndonjë nxënës nuk jep përgjigje të saktë, mos kërkoni nga nxënësi më i mirë që të jep përgjigjen e saktë, por filloni diskutimin për atë se çka mund të mësohet nga përgjigja e gabuar. (si psh: AA ... Ka menduar se e ka zgjidhur detyrën kështu... Çka mendoni, pse ka zgjidhur ashtu detyrën? Çka mund të sqarojmë në lidhje me përgjigjen e BB?).
- ▶ Mos jepni shenja joverbale për pakënaqësinë nga përgjigjia. Më mirë parashtroni pyetje plotësuese e cila do ta orineton të menduarit/përgjigjen e nxënësit.
- ▶ Në fund të orës ose në kohë tjetër përkatëse bisedoni vetë me nxënësin për përgjigjen të cilës i ka dhënë përgjigje të gabuar.

PYETJET DHE NDJEKJA

E PUNËS SË NXËNËSVE

Parashtrimi i pyetjeve dhe përgjigja e tyre është një mënyrë në të cilën arsimtari mund të fiton informatë për të mësuarit e nxënësve.

Ndjekja e paorinetuar – Arsimtari me shikim ndjek punën e nxënësve, a janë të angazhuar në mësim për të intervenuar në rast se vëren se disa nga nxënësit nuk ndjekin, nuk punojnë në detyrën e dhënë. Këtë e bën gati se vazhdimisht gjatë orës mësimore.

Mënyrë tjetër e shpeshtë është puna e nxënësve. Kjo është e pakalueshme kur punohet për aktivitetet praktike (si psh: të shkruarit, puna me mjete konkretizuese) dhe për sjelljen e nxënësve.

Të dyja mënyrat janë të lidhura ngushtë për shkak se aktiviteti i nxënësve shpesh është nxitur nga pyetjet ose detyrat të cilat i jep arsimtari.

Ndjekja e punës dhe sjelljes së nxënësve është veçanërisht e rëndësishme kur nxënësit janë në klasat fillestare ku shpesh shfrytëzohen mjete konkretizuese dhe ende nuk kanë mësuar që të përgjigjen në pyetjet e arsimtarit të fokusuar.

Ndjekja e orientuar –

Arsimtari për së afërmi dhe shpesh me planifikim ndjek aktivitetin e ndonjë nxënësi ose grupi të nxënësve. Të dhënat në lidhje me të mësuarit, kualitetin e përgjigjes, diskutimin ... i vëren. Në këtë mënyrë të orientuar mund të ndiqni 2 – 3 nxënës gjatë ditës.

Ndjekja dhe të shënuarit është aktivitet i cili kërkon më tepër kohë dhe për ta lehtësuar:

- ▶ Paraprakisht planifikoni se cilët nxënës do të ndiqni;
- ▶ Kur do të planifikoni ndjekje të orientuar, zgjidhni aktivitet, detyrë që mund të ju jap informata të vlefshme për të mësuarit, të kuptuarit dhe sjelljen e nxënësit/nxënësve;
- ▶ Ndjekjen mund ta kombinoni me parashtrime të pyetjeve;
- ▶ Paraprakisht përgatitni instrumente (çek – lista, formularë) për shënime. Mund të vendosni shifra për shënime më të shpejta;
- ▶ Vazhdimisht mbani fleta të zbrazëta (ose fletore) në të cilat do të shënoni shënimet e paplanifikuara të rëndësishme (shënime anekdotike);
- ▶ Siguroni që nxënësit e tjerë (të cilët nuk janë në fokusin e ndjekjes suaj) të jenë të angazhuar me aktivitete përkatëse;
- ▶ Vëzhgoni “përgjoni” diskutimin në çifte dhe grupe, mund t’ju jep informata të rëndësishme për diturinë dhe të kuptuarit e nxënësve, gjatë së cilës mund të merrni shënime.
- ▶ Rikthehuni më vonë në shënimet dhe interpretoni se çka ju tregojnë shënimet për:
1. Të mësuarit – a ka kuptuar nxënësi, a është përgjigjur mirë në pyetjen/detyrën e parashtruar, çfarë gabimesh ka bërë dhe 2. Sjellja – si ka reaguar nxënësi kur ka hasur në probleme (sa ka qenë i motivuar , këmbëngulës, sa ka qenë i fokusuar në detyrën e dhënë);
- ▶ Nëse keni mundësi, për diçka që është me rëndësi të veçantë, bëni inçizim të orës/aktivitetit dhe më vonë analizoni me kujdes aktivitetin e nxënësve. Nëse është përkatëse, mund ta analizoni bashkërisht me ta ose me prindërit.

Ndjekja e punës së nxënësve paraqet shkathtësi të mira për vëzhgim dhe shënim.

Ata mund të zhvillohen me ushtrime.

Nga të dhënat për punën e nxënësit të fituara me vëzhgim, silluni ngjashëm sikurse me ata të fituara nga përgjigjet e pyetjeve.

- ▶ Nëse nxënësi ka vështirësi në diçka që e bën, parashtroni pyetje në lidhje me atë që do t'ia sqaron detyrën, do ta lehtëson, orienton aktivitetin (si p.sh. Pse veprimeve ashtu ...? Çka duhet të fitosh ...? Çka do të ndodh nëse ...? A u mundove ...?).
- ▶ Jepni informatë kthyes konstruktive që nuk kritikon por që orienton.
- ▶ Shfrytëzoni të dhënat për planifikimin e punës vijuese (Tuajën dhe të nxënësve).

3.2. PËRGJIGJJA ME SHKRIM E PYETJEVE

Pasi që nxënësit do të aftësohen mjaftueshëm për shkrimlexim, për të mos patur vështirësi në të shkruar nga aspekti i shejtësisë në të shkruarit, adekuate është që të kërkohet përgjigje me shkrim e pyetjeve.

Nga aspekti i arsimitarit kjo është efiçase për shkak se kursen kohën mësimore dhe mundet të jepet si detyrë shtëpie (arsimtari mundet përgjigjet ti kontrollon dhe ti noton më vonë).

Nga aspekti i nxënësit është mirë për shkak se i jep mjaft kohë për të menduar.

Testet e llojit objektiv janë më të përshtatshme për kontrollimin e njohjes së fakteve. Për nxënësit më të vegjël më të përshtatshme janë detyrat me përgjigje më të shkurtë (fjalë, frazë) dhe detyrat me zgjedhje shumë anëtarëshe. Kërkojnë më shumë kohë që të bëhen, por lehtë dhe shpejtë notohen. Mund të shfrytëzohet edhe kompjuter.

Pyetjet ese janë të përshtatshme për kontrollimin e niveleve më të larta të aftësive (të kuptuarit, aftësitë për lidhshmëri, rezymë). Ata nuk mund të anashkalohen në gjuhë gjatë kontrollimit të të shkruarit, por janë të vlefshme në të gjitha lëndët. Lehtë formulohen por kërkojnë shumë kohë për notim.

Te pyetjet ese me përgjigje të kufizuar - udhëzimi për të shënuarit e përgjigjes udhëzon në kufizimin e përmbajtjes dhe madhësisë së përgjigjes, si për shembull:

- ☑ Sqaro ... (Si krijohet avulli i ujit?)
- ☑ Përshkruaj ... (Çka do të ndodh nëse znadhoet pjerrtësia nëpër të cilën lëshohet automobili për fëmijë?)
- ☑ Pse (në tregim) vajza ka qarrë?

- ☑ Çka mendon se do të ndodhë më tutje në tregim? Pse mendon ashtu?
- ☑ Sqaro se si e kontrolllove se cilat trupa notojnë në ujë?

Te këta pyetje pritet përgjigje konkrete dhe e shkurtër (një ose disa fjali).

Te pyetjes ese me **përgjigje të zgjeruar** - nga nxënësi kërkohet lirisht ti shpreh idetë dhe mendimet personale. Nuk i është dhënë mënyra se si duhet të organizohet përgjigjja. Me pyetje të këtilla kontrollohet aftësia për të shkruar dhe njohja e përmbajtjeve të lëndës mësimore të caktuar.

Aftësia për të shprehurit me shkrim kontrollohet në lëndët e gjuhës amtare dhe në gjuhët e huaja. Nxënësve ju jepet temë në të cilën do të shkruhet dhe zakonisht fitojnë nxitje dhe kahje plotësuese.

Për shembull:

- ◆ *Fëmijët kanë lozur në oborin shkollor. Ndodhi diçka e pazakontë. Mendoje dhe përshkruaje ngjarjen. Përdori fjalët : loja, shoqëria, të lumtur, topi. Mos harro ti japish titull temës. Veni re drejtëshkrimit.*
- ◆ *Shiko fotografinë. Përshkruaj personazhet dhe bën lidhshmërinë me lidhje farefisnore. Shfrytëzo fjalë dhe krahasime përshkruese.*

Me pyetje ese mund të kontrollohen dituritë nga ndonjë lëndë e caktuar, të kuptuarit, të gjykuarit në ndonjë lëmi përkatëse lëndore. Gjatë kësaj duhet të keni kujdes:

- ▶ Në pyetjen e parashtruar mos mundet që të përgjigjet vetëm në bazë të të mbajturit mend. Mos kërkoni që diçka të shpjegohet.
- ▶ Bëni lidhshmërinë e detyrës me rezultatet e pritura (pyetjet në të cilat nxënësi do të mund të përgjigjet).
- ▶ Formuloni pyetjen ashtu që nxënësi ta ketë të qartë se çfarë lloj përgjigje pritet.
- ▶ Tregoni se sa kohë ka për tu përgjigjur.

Për shembull:

- ◆ *Ekzistojnë mendime të ndryshme pse zogjtë në vjeshtë shpërngulen në jug. Shkruaj dy mendime dhe sqaro pse mendojsh se janë të sakta.*
- ◆ *Shkruaj një temë në një faqe dhe sqaro se pse është me rëndësi që ta ruajmë mjedisin. Do të notohet se sa shkaqe ke shënuar dhe si i ke sqaruar.*

4

Informata kthyese

PSE ËSHTË ME RËNDËSI INFORMATA KTHYESE KONSTRUKTIVE?

Informatë kthyese është secili reaksion verbal dhe joverbal i arsimtarit lidhur me rezultatin e të mësuarit të nxënësit: Koment, notë, lëvdatë, kritikë, gjest... Kur e përkrah dhe e përmirëson të mësuarit ajo bëhet formative.

Informata kthyese konstruktive e infromon nxënësin oër ate se sa i është afruar qëllimit dhe shfrytëzohen për tu përmirësuar mësimdhënia dhe mësimnxënia për tu arritur qëllimi.

Për përcjellje të suksesshme të nxënësit nëpër procesin mësimor me rëndësi të veçantë është informata kthyese konstruktive për shkak se ajo nxënësit i jep qasje të qartë në atë çka ka arritur, atë që e ka bërë në mënyrë të suksesshme dhe në çfarë mase e ka bërë atë, por edhe për atë që nuk e ka arritur dhe pse është ajo ashtu. Informata kthyese konstruktive i ndihmon nxënësit që ta orienton të mësuarit e mëtutjeshëm.

Në bazë të kësaj infromate, nxënësi mund ti planifikon procedurat dhe mënyrat e mëtutjeshme të të mësuarit dhe ata i mundësojnë:

- ◆ të vetëdijësohet për anët e mira e të mësuarit vetanak dhe për atë se sa ka përparuar;
- ◆ Që ti vëren anët e dobëta, vështirësitë dhe gabimet gjatë të mësuarit;
- ◆ Të merr sqarime për aktivitetet e nevojshme me të cilat do ti tejkalon vështirësitë;
- ◆ Të mendon për të mësuarit vetanak dhe ta përmirëson.

Prindërit e nxënësve, veçanërisht nëpërmjet të informatës kthyese me shkrim, kanë mundësi që vazhdimisht të fitojnë informata për atë se si fëmiju i tyre përparon, ku arrin sukses, ku paraqiten vështirësi dhe si mundet të ndihmojnë në tejkalimin e vështirësive.

Arsimtari, duke i dhënë informatë kthyese nxënësit, fokusohet në mësimnxënëin e tij dhe ashtu ka pasqyrë më të qartë për ate se si përparojnë nxënësit e tij dhe në çfarë mënyre duhet ta përshtat procesin e mësimdhënies.

4.1. KUR DHE SI JEPET INFORMATA KTHYESE

Kur jepet informata kthyese?

- ◆ Kur diçka është mirë ose e bërë shkëlqyeshëm.
- ◆ Kur gjatë punës paraqitet nevoja për orientim plotësues.
- ◆ Kur do të vëzhgohet problem i cili duhet të tejkalohet.
- ◆ Kur diçka duhet të përmirësohet.
- ◆ Kur dëshirojmë të pengojmë përsëritjen e gabimeve.
- ◆ Derisa nxënësit punojnë në ndonjë detyrë të caktuar.
- ◆ Deri sa nxënësit prezantojnë ate në çka kanë punuar.
- ◆ Pas përfundimit të detyrës së caktuar.

Si të jepet informata kthyese konstruktive?

Gjatë kohës së dhënies së informatës kthyese, arsimtari duhet të ketë parasysh qëllimin se për çka e jep, duhet të mundohet që informatat e dhëna të jenë precize, konkrete dhe të sakta.

Është mirë që informata kthyese të fillohet me lëvdata dhe potencime të asaj që është bërë mirë, pastaj të kalohet në analizën e gabimeve dhe të përfundojë me sygjerrime nga ana e arsimtarit ose propozime të ideve nga ana e nxënësit për ate se si nxënësi mundet ti përmirëson gabimet në hapat vijuese.

Informata kthyese për punën në të cilën nuk ka gabime nuk përfundon vetëm me konstatimin për kualitetin e punës së kryer por duhet të vazhdon me ide të nxënësit dhe arsimtarit për ate se si mundet të pasurohet, zgjerohet dhe të thellohet e mësuara.

Lëvdata ka veprim të fuqishëm motivues.

Besueshmërinë të cilën e tregon arsimtari se nxënësi mund ti tejkalon vështirësitë gjithashtu paraqet faktor të fortë motivues.

Lëvdata i ndihmon nxënësit që të vëren se çka është ajo në të mësuarit e tij mirë dhe duhet që të mbahet dhe të zhvillohet.

Informata kthyese nxitëse mund të jetë në formë të:

- ▶ konstatimit,
- ▶ të thënurit,

- ▶ mirënjohjes,
- ▶ lëvdatës,
- ▶ shpërblimit.

Orientimi është pjesë e rëndësishme e informatës kthyese dhe zhvillohet në mënyrë që do ti ndihmohet nxënësit të kupton se si ti përmirëson gabimet dhe ti tejkalon vështirësitë. Informata kthyese e këtillë nuk duhet të bën me personalitetin e fëmiut por të tregon rezultatet e arritura në situatë konkrete, si dhe për mundin e dhënë.

Informata kthyese orientuese përfshinë:

LËVDATE

- ▶ Potencohet dhe lëvdohet ajo që është bërë mirë ose ajo në çka nxënësi është i suksesshëm – ate që dëshirojmë që nxënësi ta mban dhe ta përforcon.

KONSTATIMI / ORIENTIMI / TË PYETURIT

- ▶ Konkretisht dhe qartë tregohet ajo që duhet të përmirësohet. Konstatimi ose orientimi mund të zëvendësohet me pyetjen me të cilën nxënësit i mundësohet që të vëren se ku gabon dhe të jep sqarime.

SYGJERIMI

- ▶ Jepet propozim ose jepen kahje konkrete për përmirësim. Keni kujdes sygjerimi duhet të jetë realisht i realizueshëm (mos të sygjerohet diçka që nxënësi nuk do të mundet ta bën). Mund të jetë edhe në formë të pyetjes (*çka mendon se mund të bësh për ...?*) që nxënësit do ti mundëson që të mundohet vetë të gjen zgjidhje.

NË ÇKA TË KEMI KUJDES

Informata kthyese ka për qëllim ti ndihmon nxënësit të mëson ose të bën diçka më mirë.

Për ate, ajo nuk duhet të paraqet jo vetëm lëvdatë, jo vetëm orientim, por shumë e informatave të cilat do ti ndihmojnë nxënësit ta përforcon ate që është mirë, do ta orienton se si ti përmirëson gabimet dhe si të zhvillohet.

- ▶ Lëvdata nuk duhet të jetë kritikë e fundit, ndërsa orientimi gjithmonë duhet të shoqërohet me diçka lëvduese.
- ▶ Informata kthyese jepet me fjalë të qarta dhe me fjali sa me të shkurtëra.
- ▶ Notohet aktiviteti ose procedura, JO personaliteti i nxënësit.
- ▶ Me informatën kthyese nuk duhet të bëhet krahasimi i nxënësit me nxënësit e tjerë.
- ▶ Informata kthyese duhet të jetë me shkrim dhe jo notuese. Në këtë mënyrë mundësohet rrjedha e komunikimit të jetë e liruar nga pozita mbrojtëse dhe reaksioni i nxënësit.

- ▶ Informata kthyese duhet të bën edhe me mundin e dhënë dhe tregon për lidhjen me rezultatet.
- ▶ Informata kthyese duhet të kyç këshilla, sygjerime, kahje, komente përkrahëse, e jo zgjidhje të gatshme ose servim i përgjigjes së gatshme.
- ▶ Orientimi duhet të jetë i drejtuar nga një aktivitet konkret, e jo në një varg aktivitete.
- ▶ Informata kthyese duhet ti mundëson nxënësit të reagon dhe të mundet ti gjen anët e forta dhe të dobëta të të mësuarit vetanak dhe të gjen mënyra për përmirësim. Për ate informata kthyese nuk duhet të jepet me shpejtësi, duhet të ndahet kohë të bisedohet me nxënësin dhe ti jepet kohë për ta “kuptuar porosinë”.

4.2. LLOJET E INFORMATAVE KTHYESE

INFORMATA KTHYESE GOJORE

Informata kthyese gojore është pjesë përbërëse e mësimdhënies. Ajo jepet në mënyë direkte ose indirekte – ka efekt të rëndësishëm në të gjithë që e dëgjojnë. Për të qenë efektive, është mirë që gjatë dhënies së saj të ndiqen disa rregulla të caktuara.

Baza e informtës kthyese kualitative është vlera e saj informative.

(Z.R.Iic, 2003)

Informata kthyese gojore duhet të jetë:

- ◆ Pozitive- ta çmon mundin që e ka dhënë nxënësi dhe të arriturat që i ka realizuar;
- ◆ Zhvillimore – të ofron kahje konkrete për mësim të mëtutjeshëm;
- ◆ Specifike – të bën me përgjigje/aktivitet/produkt konkret;
- ◆ E argumentuar me komunikim përkatës joverbal (gjeste, shprehje fytyre ...).

Kur duhet para të gjithëve të jepni koment të përgjigjes jo të saktë, shfrytëzoni mundësinë për të mësuarit nga gabimet – *Mirë, bëre gabim, shumicës i ndodh kjo. Hajde të shikojmë se ku është gabimi dhe pse ndodhi?*

INFORMTA KTHYESE ME SHKRIM

Gjatë informatës kthyese me shkrim duhet të merren parasysh të priturat e nxënësit dhe arsimitarit, qëllimet mësimore dhe rezultatet e pritura mësimore dhe bindjet e gabuara si dhe vështirësitë e nxënësve.

Informata kthyese me shkrim duhet:

- ◆ Të tregon se a është nxënësi në rrugë të drejtë;
- ◆ Të stimulon korigjimin e gabimeve ose përmirësimin e ndonjë pjese të caktuar të punës;

- ◆ Të udhëzon nxënësin në hapat vijuese;
- ◆ Të thirret në përparimin e bërë gjatë disa tentimeve të njëpasnjëshme;
- ◆ Ti nxit nxënësit ta shqyrtojnë punën vetanake detajisht;
- ◆ Të jep mundësi nxënësit të ndërmarin diçka.

INFORMATA KTHYESE JOKONSTRUKTIVE	INFORMATA KTHYESE KONSTRUKTIVE
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nuk jep informatë se çka është ajo që është mirë. ◆ Nuk tregon ate që është bërë gabimisht. ◆ Nuk orienton se si të përmirësohet gabimi. <p><i>Shembull:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ shumë mirë. ◆ mundohu më tepër. ◆ vizatohet përsëri. ◆ mendo logjikisht. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Tregon në ate që është bërë mirë. ◆ Detekton gabimin ose problemin. ◆ Orienton si të zgjidhet problemi por nuk jep zgjidhje të gatshme. <p><i>Shembull:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ <i>Mirë i ke paraqitur të gjitha elementet e detyrës. Gabime bëjsh kur duhet ti gjejsh lidhjet dhe operacionet ndërmjet tyre. Rikujtohu në fjalët sipas të cilave i caktojmë operacionet.</i>

Dhënia e informatës kthyeje konstruktive në mësim ndikon në zhvillimin e kornizës të së menduarit, vetëbesimit dhe motivimit për të mësuar te nxënësit.

Gjatë dhënies të informatës kthyeje, arsimtari, përveç asaj që duhet të ketë kujdes në kualitetin e informatës kthyeje, duhet të ketë kujdes edhe për ate se me shembullin e tij i mëson nxënësit ta zhvillojnë këtë shkathtësi.

Duke dhënë informatë kthyeje dhe duke i nxitur nxënësit që vetë ta kërkojnë, ai nxit shkëmbimin e mendimeve ndërmjet nxënësve. Nëpërmjet të

vetëvlerësimit dhe notimit të ndërsjelltë të nxënësve ushtrohet edhe dhënia e informatës kthyeje nxënës - nxënës, me çka nxitet zhvillimi i të menduarit kritik dhe ushtrohet formulimi dhe të kuptuarit e informatës kthyeje.

Informata kthyeje e shkruar kërkon mjaft kohë, por me shfrytëzim masovik të kompjuterëve ajo në masë të madhe lehtësohet. Veçanërisht nëse edhe punimet e nxënësve janë në formë elektronike.

Arsimtari duhet të kontrollojë se në çfarë shkalle nxënësit e kuptojnë informatën kthyeje të cilën jua jep dhe a ekziston nevoja që të riformulohet ose të risqarohet. Në paralele duhet të krijohet atmosferë e besimit reciprok ku asnjëri nuk do të ndjehet keq nëse ka gabuar, nëse pyet, nëse diçka nuk ka kuptuar ose nëse kërkon ndihmë nga arsimtari ose nga ndonjë nxënës.

5 Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjelltë

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Vetëvlerësimi (vetënotimi) është proces nëpërmjet të cilit nxënësit vijjnë në informata për të mësuarit vetanak dhe e notojnë përparimin e tyre.

”Vetëvlerësimi është larg asaj që të jetë luksoz, në realitet ajo është komponentë e rëndësishme në notimin formativ... Nëse dëshirojmë që notimi formativ të jetë produktiv, nxënësit duhet të ushtrohen që të vetënotohen, ashtu që të mund ta kuptojnë funksionin kryesor të të mësuarit të tyre dhe ashtu të kuptojnë se çka duhet të bëjnë që ta arrijnë qëllimin”.

(Black & Wiliam, 1998)

Kur dikush tenton të mësojë, me rëndësi janë tre gjërat vijuese:

- ◆ Qëllimi që dëshiron ta arrijnë,
- ◆ Të dhëna për gjendjen vijuese dhe
- ◆ Të kuptuarit e caktuar se si të bëhet urëzimi i dallimeve ndërmjet dy të parave.

Të tre elementet duhet në një shkallë të konsiderueshme të kuptohen nga nxënësi, në rast se dëshirohet që ai të ndërmarrë diçka për ta përmirësuar të arriturën. (Black & Wiliam, 1998).

Vetënotimi është proces i rëndësishëm në notimin formativ nga i cili dobi kanë edhe nxënësi edhe arsimtari.

Nxënësve ju ndihmon:

- ◆ Të vetëdijësohen si nxënës, kjo është me rëndësi për zhvillimin e aftësive metakognitive dhe për të mësuarit e përrjetshëm;
- ◆ Të fitojnë vetëbesim dhe të parashtrojnë qëllime realiste të arritshme;
- ◆ Gradualisht të kontrollojnë të mësuarit vetanak dhe në atë mënyrë të marrin përgjegjësinë për të arriturat.

Arsimtarëve ju ndihmon:

- ◆ Të fitojnë pamje më të mirë në të mësuarit dhe të kuptuarit e nxënësve, sidomos në pjesën që ka të bën me mundin e dhënë dhe ndjenjat e nxënësit;
- ◆ Nxënësit i pranojnë qëllimet si të vetat dhe janë më të angazhuar në mësim.

5.1. SI TË SIGURONI VETËNOTIM KUALITATIV?

Vetënotimi (vetëvlerësimi) është proces i ndërlikuar, por hulumtimet kanë treguar se me ushtrime ai mund të përmirësohet.

Në aftësimin e nxënësve për vetëvlerësim, më së miri është të ndiqet logjika e notimit formativ, në realitet të aftësohet nxënësi të përgjigjet në pyetjet lidhur me të mësuarit:

Te nxënësit e moshës më të vogël “mungesa e shkathtësive kognitive për ti integruar informatat për aftësitë e tyre shpiejnë deri te notimi i vetënotimit të tyre, shpesh “dëshira të shkreta”.

(Ross, 2006)

- ▶ Çka dua të arrij? (Vetëdije për qëllimet).
- ▶ Deri ku jam në rrugën deri te qëllimi? (Vetëdije për kriteret dhe të arriturat vetanake).
- ▶ Çka është vijuese që duhet ta bëj që ta arrij qëllimin? (Vetëdije për procesin e të mësuarit).

Nxënësit duhet ta vlerësojnë procesin e të mësuarit vetanake (*si mësova...*), rezultati (*sa mirë e bëra ...*), ndjenjat vetanake (*si ndjehesha...*). Krijoni situata të ndryshme në të cilat nxënësit do të mësojnë se si të vetëvlerësohen.

Tregoni nxënësve se vetënotimi dhe notimi i ndërsjellët nuk do të ndikojnë në notën e tyre, por atyre dhe juve do tju ndihmojë që më mirë ta planifikoni dhe ta organizoni të mësuarit e tyre. Kur do të binden se ajo nuk do të keqpërdoret (nga arsimtari ose nga nxënësit e tjerë) ato do të mund ti pranojnë vështirësitë/gabimet në mësim pa ju zvogëluar vetëbesimi dhe do të dijnë se mund të fitojnë ndihmë për ti tejkaluar.

MËSONI NXËNËSIT QË TË PARASHTRONJË QËLLIME

Nxënësit më të vegjël nuk kanë qëllime të qarta pse diçka mësojnë. Mirëpo, ata mund ti kuptojnë dhe ti pranojnë si të vetat qëllimet afatshkurte dhe rezultatet e pritura.

- ▶ Bisedoni me nxënësit për ate se çka duhet të mësojnë/bëjnë.
- ▶ Ndihmoni të kuptojnë se si duhet të duket puna e kryer mirë (punimi i shkruar mirë, përgjigja e mirë, çfaqje e mirë). Mund t’ju tregoni shembuj, më së miri është që ato të jenë të nxënësve nga ndonjë gjeneratë e mëparshme. Le të ushtrojnë që të parashtrorjnë qëllime afatshkurte. Ata do ti formulojnë me gjuhën “e tyre”. Mirë është që ti shënojnë që të munden më vonë që të kontrollojnë se a i kanë arritur.
- ▶ Kohë pas kohe me atë kthehuni në qëllimet të cilat i keni parashtruar për të kontrolluar se deri ku janë në të arriturat e tyre.

MËSONI NXËNËSIT QË TI NOTOJNË **TË ARRITURAT DHE PUNËN**

„Vetëvlerësimi negativ mund të sjell që nxënësit të parashtrojnë qëllime joreale, të pranojnë strategji joefektive, të japin pak mund dhe të gjejnë arsye për mosesuksin”.

(Stipek, Recchia & McClintic, 1992, sipas Ross, 2006)

Bisedoni me nxënësit për të mësuarit e tyre dhe për të arriturat, për anët e forta dhe të dobëta. Ndhmoni që vetë ta notojnë punën dhe punimet vetanake me ndonjërin nga teknikat për notim, por ashtu që të jetë e përshtatur në gjuhën të cilën nxënësit do ta kuptojnë.

Mund të përgjigjen në pyetjet (çka mësova, çka duhet të bëj në vijim?) (teknika dy yje një dëshirë), të organizoni aktivitetet “ mësojnë nga gabimet vetanake”, të shfrytëzojnë instrumente të ngjashme ashtu siç shfrytëzoni edhe ju për notim: çek - lista, organizatorë grafik, rubrika ose simbole më të thjeshta (gishti i madh lartë - poshtë, semafori, fytyra e mrolur - qesharake dhe ngjashëm) për tu vetënotuar.

- ▶ Njoftoni nxënësit se si ti shfrytëzojnë instrumentet. Mund ti formoni sëbashku me ta. Për shembull, do të zgjidhni punime me kualitet të ndryshëm dhe me nxënësit do ti rangoni. Bisedoni për ate se çka e bën ndonjë punim më të mirë nga punimi tjetër.
- ▶ Jepni kohë të mjaftueshme për vetënotim për të menduar për të mësuarit vetanake ose ta shqyrtojnë punën vetanake dhe ta krahasojnë me kriteret.
- ▶ Jepni mundësi nxënësve që ti krahasojnë të dhënat nga vetënotimi me notimin nga ana e arsimtarit ose nga nxënësit e tjerë.
- ▶ Kohë pas kohe, mblidhni vetënotimet e nxënësve që të infromoheni deri ku janë në zhvillimin e aftësisë për vetënotim. Kur do tu jepni informatë kthyesë në lidhje me vetënotimin, keni kujdes që të jetë nxitëse, bisedoni për ate se çka mendojnë, si kanë vepruar me vështirësitë etj.

MËSONI NXËNËSIT QË TI PLANIFIKOJNË **HAPAT VIJUESE NË MËSIMNXËNIE**

„Kur nga nxënësit kërkohet të mendojnë për të mësuarit vetanake, të mendojnë për ate se çka kanë mësuar dhe çka ende duhet të mësojnë, atëherë të arriturat e tyre zmadhohen“.

(Black & Wiliam, 1998)

Që të bëhen “pronarë” të vertetë të të mësuarit, me rëndësi është që nxënësit të mundën ti planifikojnë hapat real të të mësuarit.

- ▶ Ndhimoni nxënësve të bëjnë plan real aksional i cili do të jetë i lidhur me qëllimet dhe me rezultatet nga vetënotimi dhe notimi.
- ▶ Kujdesuni që të përkrahni të mësuarit e nxënësve dhe të krijoni situata në të cilat ata do të jenë të suksesshëm.
- ▶ Udhëzoni nxënësit që ti zgjedhin dhe ti ruajnë faktet se përparojnë në mësim. Ndhimoni që ta vërejnë përparimin vetanë. Mund të fillojnë të krijojnë portfolion e tyre cila do ta dokumenton përparimin.
- ▶ Mbikqyrni realizimin e planit dhe përparimin nga qëllimet. Portfolioja e nxënësit mund t'ju ndihmon në ate.

5.2. NOTIMI I NDËRSJELLTË

Në notimin e ndërsjelltë nxënësit i analizojnë punimet ndërmjet vehtes duke shfrytëzuar kahje ose instrumente për notim për t'ju dhënë mendim për punimin dhe për ate se si mund të përmirësohen.

Pasi që nxënësit do të kenë sadopak përvojë me vetënotimin, mund të kyçni notimin e ndërsjelltë.

Notimi i ndërsjelltë ka për qëllim që nxënësit më mirë ti kuptojnë qëllimet dhe kriteret dhe ti ndihmojnë njëri tjetrit në mësim. Shpeshëherë nxënësit mund ti sqarojnë gjërat më mirë njëri tjetrit. Duke notuar punimet e njëri tjetrit, nxënësit mendojnë edhe për punën vetanake dhe ndaj saj sillen më me kujdes.

- ◆ Gjatë notimit të ndërsjelltë, me rëndësi është që nxënësit të aftësohen që ti japin informatë kthyesë konstruktive njëri tjetrit. Ajo ka të bëjë me përmbajtjen e produkteve, proceseve ose prezantimeve.
- ◆ Duke ju dhënë njëri tjetrit ide se si mund ta përmirësojnë punën vetanake, nxënësit shkëmbejnë strategji të suksesshme për mësim.
- ◆ Notimi i ndërsjelltë efektiv duhet të jetë i planifikuar, i strukturuar mirë dhe të realizohet në atmosferë të besimit të ndërsjelltë.
- ◆ Gjatë notimit të ndërsjelltë te nxënësit më të vegjël mund të paraqitet tendenca për krahasim dhe gara të ndërsjellta. Mundohuni që ti ikni kësaj situatë.

Objektiviteti i notimit të ndërsjelltë zmadhohet me ushtrime.

Kur nxënësit do të fitojnë shkathtësi për vetënotim dhe notim të ndërsjelltë dhe kur do të arrijnë nivelin e kënaqshëm të objektivitetit, shfrytëzimi i këtyre teknikave, përveç dobive të tjera mund ta zvogëlon punën e arsimitarit në lidhje me notimin.

6 Planifikimi në bazë të refleksionit

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Nëse nuk bëjmë refleksion, ne mësimdhënien e bëjmë sikur në erësirë, pa e ditur se a jemi efektiv ose duhet ta ndryshojmë mësimdhënien tonë.

Roli i refleksionit në mësim (The Role of Reflection in Teaching-Qatar University).

(Professional learning and research journal)

Arsimtarët, për ate se çka ndodh në praktikën e tyre, shpesh mësojnë nga përvojat e kolegëve të tyre, por edhe nga përvojat vetanake.

Duke menduar për ate se çka qenë dhe pse ka qenë e suksesshme në mësimdhënien e tyre, çka është ajo që mund të përmirësohet dhe çka është ajo duhet të ndryshojë, ata në realitet mendojnë për ate se si mundet ta planifikojnë procesin e mësimdhënies për të dhënë efekte më të mira të mundshme në të arriturat e nxënësve.

Duke menduar për ate se pse disa nxënës arrijnë rezultate të mira dhe përparojnë në mësim, ndërsa disa ballafaqohen me vështirësi, ata mendojnë për ate se cilat mënyra të mësimdhënies, cilat metoda dhe teknika mund të zbatohen për tu tejkaluar vështirësitë dhe të arihet përparim.

Mënyra e këtillë e të menduarit quhet refleksion.

6.1. ÇKA ËSHTË REFLEKSIONI?

Refleksioni, arsimtarit i lejon që të rishikon vehten edhe në punën e tij si dhe të vendos se çka është ajo të cilën do ta vazhdon ta bën, dhe çka është ajo që do ta ndryshon.

Refleksioni paraqet proces sistematik të mbledhjes, kontrollimit dhe analizimit të perceptioneve tona, përshtypjeve dhe mendimeve për porcesin vetanaktë mësimdhënies por edhe për porcesin e mësimnxënies të nxënësve tonë dhe në bazë të atij planifikimi, ndryshimi, dhe përshtatje të praktikës mësimore me qëllim që të arrihen rezultate më të mira.

- ◆ Nëse mësimdhënia ka qenë e mirë dhe i kemi arritur rezultatet e planifikuara, do ta përshkruajmë dhe do të tregojmë pse ajo ka qenë e suksesshme.
- ◆ Nëse nxënësit nuk e kanë kuptuar atë që i kemi mësuar, do të mendojmë çka është ajo që ka ndodhur dhe pse nuk kemi qenë të qartë.

Në realitet, refleksioni na mundëson ti shohim dhe ti rregullojmë impresionet dhe ndjenjat pas realizimit të orës ose aktivitetit, të vërejmë diçka që na ka befasuar ose diçka që na ka detyruar ta rishqyrtojmë, të mendojmë për atë se çka mund të bëjmë ndryshe.

Në fund të çdo mësimdhënie mund të bëhet rishqyrtim i përvojës vetanake dhe të analizohen efektet.

KUR TË BËHET REFLEKSIONI?

Para mësimdhënies ose gjatë kohës së planifikimit të mësimdhënies.

Ashtu siç nxënësi gjatë kohës së zgjidhjes të ndonjë problemi shkencor duhet të mendon, ashtu edhe arsimtari duhet të mendon për problemet lidhur me mësimdhënien kur mëson.

Roli i refleksionit në mësim (The Role of Reflection in Teaching-Qatar University).

Në këtë periudhë refleksioni paraqet proces të parashtrimit të qëllimeve, të menduarit për atë se çka presim nga nxënësit (rezultatet) dhe zhvillimi i planit për atë se si do ti mësojmë. Me rëndësi është, duke menduar për nxënësit tuaj, ti parashtroni pyetjet vijuese:

- ▶ Çka dëshiroj të arrijnë nxënësit e mi?
- ▶ Cilat forma të mësimdhënies tani do të jenë më efektive?
- ▶ Si do ti zbatoj ata në punë me nxënësit e mi?
- ▶ Çka do të ndodh nëse nxënësit nuk reagojnë ashtu siç pres? Çka nëse nuk më kuptojnë? Çka nëse fitojnë përgjigje ndryshe nga ato që i pres?
- ▶ Si do ta kontrolloj se çka kanë mësuar nxënësit e mi?

Gjatë kohës së mësimdhënies

Mësimdhënia e planifikuar shpesh nuk zhvillohet ashtu se si e kemi parashikuar. Dituria nuk është diçka që mundemi ta dërgojmë si letër. Ndodh që nxënësit mos të reagojnë ashtu siç kemi pritur, mos e pranojnë atë metodë të mësimdhënies që e kemi planifikuar, mos e kuptojnë atë që dëshirojnë t'ju a përcjellin ...

Nuk është e thënë që për çfarë do çmimi ora të realizohet ashtu siç është planifikuar. Mendoni për nxënësit e juaj.

Jepni pak kohë gjatë orës mësimore dhe mendoni se cilat ndryshime mund ti bëni dhe ta riaftësoni mësimdhënien në kushtet e sapo krijuara.

Pas mësimdhënies

Orë produktive nuk është ajo ku çdo gjë rrjedh ashtu siç është planifikuar, por është ajo ku të gjithë mësojnë nga njëri tjetri.

Duke u nisur nga ajo se refleksioni, planifikimi dhe mësimdhënia janë të lidhura në mënyrë ciklike, është shumë me rëndësi menjëherë pas realizmit të orës të mendohet dhe të shënohet se si ka rrjedh i tërë procesi i mësimdhënies, çka ka qenë efikase dhe pse dhe çka mund të bëhet ndryshe në periudhën që vijon. Masë themelore për suksesshmërinë janë vetë nxënësit, reagimet, dhe përparimi i tyre.

Refleksioni i bërë pas mësimdhënies na shpjen nga planifikimi i ri. Për të qenë më efikas, planifikimi i orës nuk është e thënë të jetë në formë të dokumentit të strukturuar detajisht.

Kjo duhet t'ju mundëson:

- ◆ Pasqyrim të përgjithshëm të qëllimeve dhe rezultateve – pse e bëni atë që e bëni,
- ◆ Cilat hapa i planifikoni,
- ◆ Si do ti kontrolloni të arriturat.

Në fund të orës/aktivitetit parashtroni pyetjet vijuese:

- ▶ Çka ishte mirë?
- ▶ Çka nuk ishte mirë?
- ▶ Çka do të bëj ndryshe? Pse?
- ▶ Çka do të bëj njëlloj? Pse?
- ▶ Çka ishte ndryshe nga ajo që e planifikova? Pse ndodhi kjo?
- ▶ Kishte diçka që më befasoi, nuk ishte e planifikuar?

Shembull për refleksion nga shkrim leximi fillestar nga aktiviteti për shkrim

Aktivitetet rrodhën ashtu siç planifikova. Aktiviteti hyrës (analiza e pejsazheve pranverore), për të cilën nxënësit zbritën fotografi nga interneti, u tregua shumë efikas dhe zgjoi interesim te nxënësit, nxiti shumë ide dhe ndihmoi në produktimin e detajve përcjellëse lidhur me temën.

Teknikat e zbatuara (tekst mentorimi, rrjeti i temës) ju ndihmojnë në shfrytëzimin e fjalëve përshkruese. Të gjithë nxënësit u munduan të japin fillim efikas dhe fund efikas. Nxënësit ishin të angazhuar, shfrytëzuan shumë ide. Veçanërisht ishin origjinale, me fillim dhe mbarim të mirë dhe gjuhë përshkruese punimet e Agonit, Meritës dhe Edonës.

Betimi, Albani, Era dhe Sara kishin vështirësi në zbatimin e gjuhës përshkruese, më së shpeshti shfrytëzuan fjali të thjeshta, ndërsa rrallë herë figura stilistike dhe fjalë për shprehjen e ndjenjave dhe citimeve. Në përfundime më pak shfrytëzuan fjali me rikthim në fillim dhe rumbullaksim të tregimit. Me ata do të mundohen më tepër ti shfrytëzoj teknikat: rradhitja e fjalëve, shkrim, stuhi ideshë dhe do ti orientojë më së shpeshti të shfrytëzojnë fjalë përshkruese.

6.2. REFLEKSIONI NË BAZË TË DHËNAVE TË MARRA NGA NXËNËSIT

Kriter kyç për suksesin e mësimdhënies janë reagimet dhe të arriturat e nxënësve. Për ate është me rëndësi arsimtari deri në fund të orës/ditës të ketë të dhëna për ate se çka kanë mësuar nxënësit. Ata mund ti grumbullon nëpërmjet të ndonjë teknike për (vet) notim të shpejtë (fytyra të mrolura – qesharake, dy yje një dëshirë, porosi për fund, kuiz), nëpërmjet vëzhgimit dhe diskutimit me nxënësit në orë.

Gjatë procesit mësimor nxënësit vijnë deri tek faza kur vetëdijësohen për ate që kanë mësuar edhe ate kur vetë mundet ta sqarojnë dhe ta vendojnë në ndonjë funksion të ri. Këte zakonisht e shohim gjatë vetënotimit kur nxënësit ju përgjigjen pyetjeve: *Çka mësova? Çka dua të di? Si do ta zbatoj ate që ë kam mësuar?*

Në këtë mënyrë nxënësit vetëdijësojnë mënyrën vetanake për mësim dhe arritje deri te zgjidhja, ndërsa arsimtarit i jepet mundësi në bazë të aktiviteteve të nxënësve të jep edhe një dimension të refleksionit.

Në lidhje me të mësuarit e nxënësve mund ti parashtroni pyetjet vijuese:

- ▶ A mësuan nxënësit e mi ate çka kam pritur? Sa nga ta mësuan dhe sa jo? Cilët nxënës kishin vështirësi?
- ▶ A munden nxënësit e mi me fjalët e tyre të sqarojnë çka kanë mësuar dhe pse është ajo me rëndësi?
- ▶ A mund të japin shembull për zbatim ose të bëjnë aktivitete me të cilin do të tregojnë se janë në gjendje ta zbatojnë ate që janë mësuar?
- ▶ A mund ta vlerësojnë punën dhe të arriturat e tyre në raport me rezultatet me të cilat i njoftova? A mund ta planifikojnë të mësuarit e tyre të mëturshëm?

Edhe pse mund të duket e komplikuar, të menduarit reflektiv ushtrohet dhe me kohë bëhet rutinore.

Bërja e refleksionit nuk është punë administrative por qasje profesionale drejt përparimit të punës vetanake. Ndonjëherë nuk duhet vetëm formalisht ta shënoni refleksionin. Me rëndësi është të mendoni për punën tuaj dhe të gjeni mënyra ta përmirësoni. Ashtu do të jeni edhe ju më të kënaqur edhe nxënësit tuaj.

7 Informimi i prindërve

ÇKA ËSHTË ME RËNDËSI?

Qëndrimet e prindërve ndaj shkollës, mësimit dhe arsimtarit, në masë të madhe përgjithmonë caktojnë raportin e nxënësit ndaj mësimit.

Se sa prindërit do të angazhohen në të mësuarit e fëmiut të tyre në masë të madhe më tepër varet nga arsimtari, se sa nga disa karakteristikat e familjes.

(Epstein, 1996)

Prindërit duhet të kyçen në të mësuarit e fëmijëve të tyre që nga dita e parë e shkollës. Ata janë të interesuar dhe kanë të drejtë të dinë:

- ◆ Çka do të mësojnë fëmijët e tyre,
- ◆ Si do të zhvillohet mësimi,
- ◆ Si do të notohen,
- ◆ Sa janë të suksesshëm në mësime,
- ◆ Çfarë përkrahje mund t'ju japin ata.

Në rast se fitojnë informata të sakta dhe në kohë, prindët do të mundin ti japin përkrahje përkatëse në mësime fëmiut, qoftë ajo të bën vetëm këshillim dhe vëzhgim, ose të jetë më direkte dhe përfshinë ndihmë në të kuptuarit e përmbajtjeve.

Prindërit të cilët në kontinuitet janë të informuar për qëllimet mësimore dhe për të ariturat e fëmiut të tyre, më mirë do ti kuptojnë dhe do ti pranojnë notat përshkruese.

SI TI INFORMONI PRINDËRIT?

Notimi për pjesën më të madhe të prindërve është dhënia e notës. Ajo ju tregon se në cilën shkallë ka arritur fëmiu i tyre në “shkallën e diturisë” me pesë nivele. Pak ju tregon se çka duhet të bëjnë nëse fëmiu i tyre nuk është në maje.

Sa më mirë që informohen për të mësuarit dhe përparimin e fëmiut të tyre, aq më tepër prindërit bëhen bashkëpunëtorë të arsimtarit.

- ▶ Në fillimi të vitit shkollor informoni për qëllimet e secilës lëndë mësimore: çka pritet nxënësit të mësojnë deri në fund të vitit. Mirë është që t'ju a jepni në formë të shkruar rezultatet sipas muajve për të mundur të ndjekin se si përparon fëmiu i tyre. Shkruani në gjuhë të thjeshtë të cilën do ta kupton secili prind.

Prindërit shpesh herë mbivlerësojnë fëmion e tyre për shkak se nuk kanë informata se çka mund të arrinë fëmiu i tyre në moshë të caktuar.

Hulumtimet tregojnë se vet të treguarit e interesimit nga ana e prindërve për ate se çka ka mësuar fëmiu në shkollë është e lidhur me të arriturat me të larta të nxënësve në matematikë në mësimin klasor.

(Programi i UNICEF-it: Arsimi inkluziv për grupet e rrezikuara, Raport nga hulumtimi në gjendjen fillestare, 2015).

- ▶ Sqaroni atyre se nuk do t'ju jepni nota numerike deri në klasën e tretë dhe se përshkrimi do të jetë formativ, dhe se notim sumativ do të bëni në klasën e katërt dhe të pestë.
- ▶ Merruni vesh me mënyrat e komunikimit: gojarisht, me shkrim, në mënyrë elektronike.
- ▶ Ashtu siç do ti njoftoni nxënësit me kriteret për punime kualitative, në të njejtën mënyrë duhet ti njoftoni edhe prindërit. Ate mund ta bëni ashtu që do t'ju dërgoni kriteret për notim të punimeve më të rëndësishme (si psh. Përmbajtje me shkrim), do t'ju sqaroni notimin në zgjidhjen e problemeve nga matematika ose notimin në përgjigjen e pyetjeve nga shkencat natyrore, dhe do ti ekspozoni në klasë punimet më kualitative.
- ▶ Udhëzoni në ate se kur do t'ju jepni fëmijëve informata kthyesë me shkrim dhe si ata ti shfrytëzojnë për ti ndihmuar fëmion. Merruni vesh se çfarë informate kthyesë në lidhje me këte pritni nga ta.
- ▶ Udhëzoni prindërit se si ta përkrahin fëmion për të mësuar nga përgjigjet e gabuara vetanake dhe mos të dorëzohet kur do të ballafaqohet në vështirësi.

- ▶ Sqaroni atyre kur dhe pse shfrytëzoni vetënotim dhe notim të ndërsjelltë. Veçanërisht bisedoni për përkrahjen të cilën mund t'ia japin fëmion në parashtrimin e qëllimeve reale dhe ndjekjen e të arriturave të tyre. Nëse nxënësit kanë portfolio, prindërit le ti ndihmojnë në zgjedhjen e punimeve dhe le të bisedojnë për ate se pse ndonjë punim është më i mirë.
- ▶ Kohë pas kohe organizoni takime të përbashkëta me prindin dhe fëmion, ku fëmion do ta sqaron të mësuarit e vet, të arriturat dhe përparimin. Punimet nga portfolio mund ti shfrytëzojnë për argumentim të mendimeve vetanake.
- ▶ Krijoni klimë të besimit të ndërsjelltë në të cilën prindi do t'ju jap informatë për të mësuarit e fëmion të tij dhe do të jetë i sigurtë se do ti shfrytëzoni vetëm për përmirësimin e të mësuarit e tij.

Nuk mundet të gjithë prindërit t'ju japin përkrahje adekuate në mësim fëmijëve të tyre, por të gjithë mund të tregojnë interesim dhe të gjejnë pak kohë që ti pyesin fëmijët se çka kanë mësuar dhe çka mbajnë mend. Arsimtari mundet t'ju ndihmon që më mirë të kuptojnë se si përparon fëmion i tyre.

8 Shtojca

8.1. SHFRYTËZIMI I TAKSONOMISË SË BLUMIT NË NOTIM

NIVELI	SHEMBUJ TË FOLJEVE ME TË CILAT DEFINOHEN RREZULTATET	PYETJE TË MUNDSHME	MËNYRA ME TË CILAT MUND TË NOTOHET
<p>DITURI</p> <p>Nxënësi mund të njoh dhe të rikujtohet në: të dhëna, terme, simbole, koncepte themelore dhe përgjigje që i ka mësuar.</p>	<p>Përsërit, përshkruan, njeh, lidh, emërron, tregon.</p>	<p>Si quhet ...? Ku gjendet ...? Kur ndodhi ...? Si është ...? Kush ka qenë? Çka është... ? Si do ta përshkruash ...? Mund të rikujtohesh në ...? Si do të tregosh ...? Kush nga këta është ...? Mund ti numërosh ...?</p>	<p>Shpjegim, përsëritje, përgjigje në pyetje, test me detyra.</p>
<p>TË KUPTUARIT</p> <p>Nxënësi tregon kuptim për faktet dhe idetë nëpërmjet organizimit të tyre, krahasimit, përshkrimit, interpretimit dhe nxjerrjes së ideve themelore.</p>	<p>Organizon, sqaron, përshkruan, krahason, definon, klasifikon, mbledh, parashikon.</p>	<p>Çka mendon pse ...? Cilat janë karakteristikat themelore ...? Si do ti krahasosh ...? Si do ti sqarosh me fjalët e tua? Çka don të thotë ...? Me çka do të tregosh ...? Çka mund të thuash për ...? Si do të mbledhish ...? Kush është përgjigja më e mirë...?</p>	<p>Shpjegim me fjalët e tua, përgjigje në pyetjet ese, organizatorët grafik, shfrytëzimi i vizatimeve, skema.</p>



<p>ZBATIMI</p> <p>Nxënësi zgjidh probleme duke i shfrytëzuar në mënyrë të re dituritë e fituara, teknikat, procedurat, rregullat.</p>	<p>Shfrytëzon, ndërton, zgjedh, zhvillon, organizon, eksperimenton, planifikon, zgjidh, njehson, ilustron.</p>	<p>Si do ti shfrytëzosh ...? Cila shembuj mund ti gjesh për ... ? Si do ta zgjidhish ... duke shfrytëzuar ...? Si do ti organizosh... për të treguar se ...? Cilën qasje do ta shfrytëzosh për ...? Si do të ndryshon rezultati nëse ...? Si do ti shfrytëzosh faktet, cilat pyetje do ti parashtrosh për ta gjetur ...?</p>	<p>Zgjidhja e problemeve, detyra, pyetje ese, hulumtim, vizatim diagramesh, rregullim i të dhënave, sqarimi i të tjerave, përgatitja e planeve.</p>
<p>ANALIZA</p> <p>Nxënësi zbërthen informatën në pjesë për tu kuptuar më mirë; identifikon shkaqet dhe pasojat; gjen fakte për sqarim.</p>	<p>Zbërthen, sqaron, përfundon, rregullon, debaton, jep mendim, rangon, krahason, kontrollon, zbërthen, dallon, lidh, paramendon.</p>	<p>Cilat janë pjesët përbërëse të ...? Si është e lidhur ajo me ...? Çka mendon ...? Çka janë idetë kryesore ...? Cilat janë motivet e ...? Çfarë përfundimesh mund të nxjerrish ...? Si do ti klasifikosh ...? Si janë të lidhura ...? Cilat fakte mund ti gjesh për ...? Me çka mund të arsyetohet ...?</p>	<p>Diskutime, ese, kritika, vëzhgime, debate, organizatorë grafik, teste.</p>



<p>SINTEZA</p> <p>Nxënësi i kombinon informatat në mënyrë të re, krijon struktura të reja, nxjerr përfundime dhe gjeneralizon.</p>	<p>Kombinon, krijon, konstrukton, zhvillon, formulon, paramendon, parashikon, zgjidh, planifikon, adapton, përsos, ndryshon, sqaron, lidh, ndërton.</p>	<p>Cilat ndryshime do ti bësh për ta zgjidh ...? Si do ta kontrollosh ...? Si do ta përmirësosh ...? Çka do të ndodh nëse ...? Mund ta sqarosh shkakun për ...? Mund të propozosh tjetër zgjidhje për ...? Si do ta ndryshosh ...? Çka duhet të bëhet për ta ...? Çka do të bësh për të ...? Mundesh ta parashikosh rezultatin nga ...? Mund të gjesh mënyrë të re për ...?</p>	<p>Ese kreative, punime, diskutime.</p>
<p>EVALUIMI</p> <p>Nxënësi prezanton dhe mbron mendime nëpërmjet të vlerësimit të informatave, besueshmërisë së ideve ose kualitetit të produkteve.</p>	<p>Zgjedh, përfundon, vendos, mbron, cakton, vlerëson, gjykon, argumenton, propozon, përkrah, rangon, jep mendim.</p>	<p>A pajtohesh me ...? Çka mendon për ...? Si do ta vërtetosh ...? Mund ta notosh ...? A do të jetë më mirë nëse ...? Çka propozon ...? Çka do të zgjedhish ...? Pse? Si do ta argumentosh mendimin ...? Si e arsyeton ...? Si i noton ...?</p>	<p>Debate, diskutime, kritika, ese.</p>

8.2. KATALOG I STRATEGJIVE DHE TEKNIKAVE PËR NOTIM

I. REFLEKSIONI NDAJ TË MËSUARIT

	STRATEGJIA / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
1.	PYETJE PËR REFLEKSIONE/VETË NOTIM.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Ju ndihmojnë nxënësve që të fokusohen në aspekte të caktuara të të mësuarit dhe asgje me rëndësi nuk kanë lëshuar. ◆ Siguron nxënësit të fitojnë përkrahje për vetërefleksim. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Pasi që të përfundon aktiviteti i caktuar për mësim, nxënësit marrin pyetje për notimin e të arriturave, anët e forta dhe të dobëta. Mund të marrin pyetje për ate çka kanë pasur vështirë. Përgjigjet i shkruajnë në një shirit letre dhe i lënë në një kuti veçmas për vetënotim. <p><i>Çka mësova sot në matematikë? Çka kish të vështirë?</i></p>
2.	KOHË PËR REFLEKSION.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxit nxënësit që të mendojnë për të mësuarit dhe përparimin vetanak. Mendimi për punën vetanake është thebësor për planifikimin e aktiviteteve dhe përparimin. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Arsimtari ju jep kohë nxënësve për të menduar për të mësuarit vetanak. Si psh gjatë të shkruarit të hartimit me shkrim nxënësit bëjnë pasqyrë dhe plan për përmirësim. Mund të këkrojnë ndihmë nga arsimtari ose nga nxënësit e tjerë.

II. REFLEKSIONI I SHPEJTË JOVERBAL

STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
<p>1. ARSIMTARI I PYET NXËNËSIT SE SA JANË TË SIGURTË.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mënyrë e shpejtë e grumbullimit të të dhënave për të kuptuarit gjatë aktivitetit ose në fund të aktivitetit. ◆ Ju ndihmon nxënësve dhe arsimtarit që të identifikohen lëmi, koncepte, shkathtësi në të cilat duhe të fokusohen për tu përmirësuar/ zhvilluar. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Kur ndonjë nxënës/ grup do të tregon zgjidhje ose do të shpreh mendim, arsimtari i pyet të tjerët se a mendojnë edhe ata ashtu (a është zgjidhja e saktë) dhe sa janë të sigurtë në të. Nxënësit përgjigjen me simbole joverbale. <p>Shembull: Gishti i madh lartë, gishti i madh anash, gishti i madh poshtë ose çohu në këmbë – ulu ose ngre dorë. Nxënësit, varësisht nga ajo se sa janë të sigurtë në mendimin vetanë, japin sinjalin joverbal. Nëse arsimtari dëshiron ti mbron nxënësit (që mos tregojnë para të tjerëve se nuk dinë), mund të shfrytëzon tabela me tekst përmbajtjen e së cilës do ta shikon vetë.</p>
<p>2. SEMAFORI.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mënyra për diagnostifikim vizuel të shpejtë për ate se çka dinë nxënësit ose çka kanë menduar. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Shembull: Në fillim të aktivitetit/orës për hulumtim të masave specifike (që noton, a nuk fundoset) i tregon gjësendet, ndërsa nxënësit me kartela përgjigjen se a do të noton gjësendi (kartelë e gjebërt), nuk janë të sigurtë (kartelë e verdhë) ose do të fundoset (kartelë kuqe). <p>Pas diagnostifikimit të shpejtë, arsimtari mund të vazhdon me kërkesë të sqarimit të mendimeve.</p>

III. VENDOSJA E KRITEREVE DHE NOTIMI I NDËRSJELLTË

STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
<p>1. NOTIMI I PUNIMEVE NGA NXËNËSIT E TJERË.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit mund të shohin se si duket punimi/përgjigja e mirë, kuptojnë pse ndonjë punim/përgjigje është i mirë. ◆ Ju ndihmon nxënësve të vendosin të kuptuarit e përbashkët për kualitetin e punimit (kriteret). ◆ Ju ndihmon që të parashtrojnë qëllime për përmirësimin e punimeve vetanake. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit marrin shembuj të zgjidhjeve të ndonjë detyre/problemi dhe duhet të notojnë se mënyra e zgjidhjes është e mirë, ti zbulojnë gabimet dhe të japin sygjerime për përmirësim . ◆ Nxënësve ju tregohet se si është bërë ndonjë hulumtim (shembull është ndjekur ritja e dy bimëve të ritura në kushte të ndryshme) dhe ju jepen rezultatet e hulumtimit (matje e lartësisë gjatë dhjetë ditëve). Para se ta shkruanë përfundimin dhe arsyetimin e vetë, ju jepen përgjigje dy nxënësve. Duhet ti shqyrtojnë dhe të japin përgjigje se cila përgjigje është më e mirë dhe pse. ◆ Arsimtari grupeve të nxënësve ju jep hartime me shkrim të cilat nuk janë më të mira, por që janë përafërsisht të atilla ashtu siç shkruajnë nxënësit nga ai grup. Nxënësit shfrytëzojnë kriteret për të cilat janë marrë vesh që më parë (i kanë përpunuar me arsimtarin) për ta notuar punimin. ◆ Shfrytëzohen shembuj të punimeve (hartime me shkrim, përgjigje të pyetjeve ese, punime figurative, inçizime aktivitetesh) të nxënësve nga gjeneratat e mëparshme dhe nxënësit në çifte/grupe dikutojnë pse ndonjë punim është i mirë dhe si mundet të përmirësohet.



STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
<p>2.</p> <p>NXËNËSIT VETË I NOTOJNË PUNIMET E VETA.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Ju mundëson nxënësve që në mënyrë objektive të mendojnë për punën e tyre. Më efektive është nëse ka kaluar një kohë e konsiderushme nga përfundimi i punimit. Më efektive është nëse nxënësve ju jepen instrumente për notim (për shembull çek-lista, kritere sipas niveleve). 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Para se ta dorëzon hartimin me shkrim, nxënësi vet e kontrollon dhe “jep notë” (tregon se në cilin nivel është). Shfrytëzon përshkrimet e niveleve për ta arsyetuar gjykimin e tij. ◆ Arsimtari ju jep nxënësve çelës për pyetjet e detyrave nga testi dhe pastaj secili vet i bën krahasimet e përgjigjeve vetanake me modelin e përgjigjeve. Nxënësi jua tregon prindërve testin dhe mënyrën se si është notuar.
<p>3.</p> <p>NXËNËSIT PËRGATITIN KRITERE PËR NOTIM.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Ju ndihmon nxënësve që ta kuptojnë në tërësi procesin e notimit- i orienton në atë se që të notohet ndonjë punë duhet të përgatiten kriteret. ◆ Nxënësit aftësohen ti identifikojnë aspektet kyçe të detyrës dhe ti kontrollojnë të kuptuarit deri në momentin e dhënë. ◆ Ju ndihmon nxënësve që ti dallojnë punimet me kualitet të ndryshëm. ◆ Ju ndihmon të mendojnë edhe për atë se sa puna e tyre është e mirë. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit bëjnë kritere për leximin shprehës. Duhet të caktojnë se çka gjithçka duhet të merret parasysh dhe se sa diçka është e mirë (për shembull intonacioni, respektimi i interpunkcionit, saktësia e të shprehurit, ruajtja e interesimit të dëgjuesve). ◆ Nxënësit bashkërisht i notojnë përgjigjet e detyrave nga testi ku duhet të interpretohen të dhënat e grafikut. Arsyetojnë cila përgjigje sa pika duhet të fiton dhe pse. ◆ Arsimtari ju jep nxënësve në grupe të vendosin kritere sipas të cilave do ta notojnë detyrën e shtëpisë nga gjuha shqipe. Ditën e dytë i notojnë detyrat e shtëpisë ndërmjet veti.



STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
4. NXËNËSIT PARASHTROJNË PYETJE NË LIDHJE ME PËRMBAJTJET TË CILAT I KANË MËSUAR DHE JU PËRGJIGJEN PYETJEVE TË NXËNSËVE TJERË.	<ul style="list-style-type: none"> Ju ndihmon nxënësve që ti kuptojnë rezultatet e pritura nga të mësuarit. Ju ndihmon nxënësve që të vërejnë se ekzistojnë më tepër mënyra për t’ju përgjigjur ndonjë pyetje. 	<ul style="list-style-type: none"> Në fund të temës, nxënësit shkruajnë detyra për “test” për fundin e temës. Mund ti shfrytëzojnë librat. Duhet të bëjnë edhe çels për përgjigjet. Mund të punojnë në mënyrë individuale ose në grupe. Nxënësit e tjerë duhet ta zgjidhin “testin”. Që të kursehet letër, mundet gjithçka të bëhet në mënyrë elektronike. Kutia me pyetje (detyra) – Nxënësit pyetjet e tyre i shënojnë në kartuça dhe i vendosin në kuti për ato. Arsimtari i kontrollon dhe në atë mënyrë fiton pasqyrë në ate se sa nxënësit i kanë kuptuar rezultatet e pritura. Nxënës të tjerë mund të marrin pyetje/detyra dhe t’ju përgjigjen.


IV. ORGANIZATORËT GRAFIK

STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
1. SEMAFORI.	<ul style="list-style-type: none"> Strategji e shpejtë dhe e vlefshme për kontrollimin e përparimit dhe për zbulimin e lëmive në të cilat duhet të përkushtohet më tepër kujdes. Ju mundëson nxënësve të bëjnë kontrollim të shpejtë të asaj çka e kanë arritur dhe që duhet ta përmirësojnë. 	<ul style="list-style-type: none"> Arsimtari kërkon nga nxënësit të notojnë koncepte të caktuara ose pjesë nga punimi, duke shfrytëzuar ngjyrat e dritës së semaforit: e gjelbërt – me siguri e di (me siguri është mirë)? Verdhë - nuk jam i sigurtë; Kuqe – nuk e di (nuk është mirë). Mund të kenë kartuça me ngjyrë të cilat do ti tregojnë ose mundet me ngjyra të shënojnë në fletore/fleta pune. Pastaj arsimtari mund të sqaron ate që nuk është qartë ose nxënësi ta përpunon punimin – “e verdha të bëhet e gjelbërt, ndërsa e kuqja të bëhet e verdhë”.



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
2.	RRJETE/HARTA MENDORE/ HARTA TË KUPTIMEVE.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mundëson në mënyrë të shpejtë të mbledhën shumë informata. ◆ Nxënësve jua japin “fotografinë e madhe” në fillim ose në fund të temës. ◆ Arsimitarit i ndihmon ta kupton të kuptuarit e koncepteve, lidhjeve ndërmjet tyre dhe ti zbulon konceptet e gabuara për të intervenuar në mënyrë përkatëse. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mund të shfrytëzohet edhe për hulumtimin e paraditutive. Para fillimi të temës nxënësit bëjnë hartën mendore. Arsimitari e shfrytëzon për të parë se çka dinë nxënësit, dhe ku kanë koncepte të gabuara. ◆ Nga nxënësit kërkohet të mbledhin gjithçka që dinë për dritën dhe erësirën. <div data-bbox="874 1171 1385 1736" data-label="Diagram"> <pre> graph TD A[DRITA DHE ERËSIRA] --> B[POÇI] A --> C[DIELLI] B --> D[rryma] B --> E[qarku elektrik] D --> F[centrali] C --> G[nata] C --> H[dita] I[STUFA] --> J[drunjët] I --> K[zjarri] </pre> </div>



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM								
3.	TREKËNDËSHI.	<ul style="list-style-type: none"> Në trekëndësha të ndryshëm nxënësit shkruajnë përvojat nga të mësuarit. Ju ndihmon nxënësve që ti lidhin përvojat nga aspektet e ndryshme të të mësuarit (emocione, shqisa, kognitiv). 	<ul style="list-style-type: none"> Shrytëzohet për ndarje të aspekteve të caktuara të të mësuarit. Ekzistojnë katër trekëndësha të lidhur me të mësuarit. Për pyetjet mund të merren vesh edhe nxënësit . Si për shembull pas aktivitetit hulumtues nxënësit janë vetënotuar duke i shfrytëzuar pyetjet vijuese: Çka vërejtta? Çka dëgjova? Çka bëra? Çka duhe të bëj në vijim? 								
4.	DDM (di, dua të di, mësova).	<ul style="list-style-type: none"> Tabela i siguron arsimtarit informata për shikim të nxënësit në të mësuarit vetanëk dhe për interesimet e tij. Nxënësve ju jep ndjenjë për kontroll ndaj të mësuarit dhe ju ndihmon ta planifikojnë të mësuarit. 	<table border="1" data-bbox="869 1485 1329 1928"> <thead> <tr> <th>Dij</th> <th>Dua të dij</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><i>Disa trupa notojnë, ndërsa disa fundosen. Trupat e lehtë notojnë më mirë.</i></td> <td><i>A fluturojnë trupat në ajër ashtu siç notojnë në ujë?</i></td> </tr> <tr> <th colspan="2">Mësova</th> </tr> <tr> <td colspan="2"><i>Disa trupa të rëndë notojnë më mirë se sa disa trupa të lehtë.</i></td> </tr> </tbody> </table>	Dij	Dua të dij	<i>Disa trupa notojnë, ndërsa disa fundosen. Trupat e lehtë notojnë më mirë.</i>	<i>A fluturojnë trupat në ajër ashtu siç notojnë në ujë?</i>	Mësova		<i>Disa trupa të rëndë notojnë më mirë se sa disa trupa të lehtë.</i>	
Dij	Dua të dij										
<i>Disa trupa notojnë, ndërsa disa fundosen. Trupat e lehtë notojnë më mirë.</i>	<i>A fluturojnë trupat në ajër ashtu siç notojnë në ujë?</i>										
Mësova											
<i>Disa trupa të rëndë notojnë më mirë se sa disa trupa të lehtë.</i>											





















	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
5.	SHKALLA/ VAZHDUESI/ VETËKONTRO- LLIM.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Kjo është nxitje vizuale e shpejtë për të menduar nxënësi se ku është (çka din) në fillim të të mësuarit dhe ku ka arritur në fund. ◆ Mundëson ndjekjen e përparimit, rit vetbesimin dhe nxënësi motivohet për të mësuar. ◆ Ju mundëson nxënësve ta masin përparimin dhe i nxitin që përmbajtjet ti ndajnë në pjesë më të vogla të cilat mund të përvetësohen. ◆ Ju ndihmon nxënësve që të bëjnë radhitje të procedurave/ përmbajtjeve për mësim. Çka i shte më me rëndësi? Çka kuptova më mirë? 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Për shembull: nxënësit në çdo pengesë të shkallës duhet ti rradhitin punët të cilat i kanë mësuar sipas rëndësisë ose sipas asaj se sa mirë i kanë kuptuar. ◆ Në fillim të temës/gjysmëvjektorit, për shembull në matematikë, nxënësit në shkallë shënojnë se çka dinë. Në fund përsëri rikthehen të shikojnë se sa kanë përparuar.
6.	DIAGRAMI I VENIT/ DIAGRAMET ME RELACIONE.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Janë të nevojshme për kontrollimin e aftësive për krahasim. ◆ Tregon se si nxënësit i kanë kuptuar lidhjet ndërmjet elementeve. ◆ Jua lehtëson punën nxënësve për ti rregulluar informatat. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Për shembull: nga nxënësit kërkohet të krahasojnë dy personzhe nga dy tregime të ndryshme. Çka ndërmjet tyre është e njëjtë dhe çka janë karakteristika të veçanta për secilin nga personazhet. <div data-bbox="884 1823 1362 1989" style="text-align: center;"> </div>



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM						
7.	PLUS, MINUS, INTERESANT.	<ul style="list-style-type: none"> I nxit nxënësit që të gjejnë se çka rrejdhtë mirë gjatë të mësuarit. Çka është pozitive, e çka negative në idenë/mendimin. 	<ul style="list-style-type: none"> Nga nxënësit është kërkuar të notojnë hartim me shkrim në afat prej disa minutave duhet të tregojnë çka është të në: mirë (+), nuk është mirë (-), çka është interesant (✓). <table border="1" data-bbox="847 488 1348 577"> <tr> <td>+ PLUS</td> <td>- MINUS</td> <td>✓ INTERESANT</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	+ PLUS	- MINUS	✓ INTERESANT			
+ PLUS	- MINUS	✓ INTERESANT							
8.	RRETHI IDEVE.	<ul style="list-style-type: none"> Nxiten procese mendore të larta. Zhvillohen aftësi metakognitive. Arsitmarët fitojnë informata për kualitetin e diturive të fituara. 	<ul style="list-style-type: none"> Arsimtari ka përgatit rreth të ndarë në katër pjesë me shenja “parashiko, sqaro, mblidh, vlerëso” me shigjetë (si orë me një shigjetë). Në fund të aktivitetit për mësime arsimtari e kthen rrethin dhe varësisht nga ajo se ku do të ndalet shigjeta parashtron pyetje përkatëse. Për shembull: nëse shigjeta ndalet tek mblidh - pyetja mund të jetë: “Cilat janë gjerat më me rëndësi të cilat i mësuam?” 						
9.	KËNDI I DREJTË.	<ul style="list-style-type: none"> Ju ndihmon nxënësve që ti ndajnë faktet nga emocionet në mënyrë shumë të dukshme. 	<ul style="list-style-type: none"> Shembull: Pas temës për ndotjen e mjedisit nxënësit i kanë shënuar faktet dhe emocionet në lidhje me ndotjen me plastika. <div data-bbox="842 1321 1316 2056"> <table border="1"> <tr> <td rowspan="2" style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">NDJENJAT</td> <td style="text-align: center;">FAKTET</td> <td> Plastika e ndot mjedisin. Plastika mund të reciklohet. Në vend të qeseve të plastikës mund të shfrytëzohet qese letre. Reciklimi është i shtrenjtë. </td> </tr> <tr> <td></td> <td> Më vjen turp kur shof që më shofin me torbë stofi në vetëshërbim. Nervozohem kur dikush nuk e ndan plastikën nga mbeturinat tjera. </td> </tr> </table> </div>	NDJENJAT	FAKTET	Plastika e ndot mjedisin. Plastika mund të reciklohet. Në vend të qeseve të plastikës mund të shfrytëzohet qese letre. Reciklimi është i shtrenjtë.		Më vjen turp kur shof që më shofin me torbë stofi në vetëshërbim. Nervozohem kur dikush nuk e ndan plastikën nga mbeturinat tjera.	
NDJENJAT	FAKTET	Plastika e ndot mjedisin. Plastika mund të reciklohet. Në vend të qeseve të plastikës mund të shfrytëzohet qese letre. Reciklimi është i shtrenjtë.							
		Më vjen turp kur shof që më shofin me torbë stofi në vetëshërbim. Nervozohem kur dikush nuk e ndan plastikën nga mbeturinat tjera.							



STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM						
10.	<p>GJASHTË KAPELAT.</p>	<ul style="list-style-type: none"> I nxit nxënësit që ti shqyrtojnë gjërat në aspekte të ndryshme. I nxit që të gjejnë argumente, pa u ndjehur keq për shkak të mendimit. Arsimtarët fitojnë informata për të kuptuarit, rezonimin, kreativitetin, aftësinë për sinteza. <ul style="list-style-type: none"> Gjatë diskutimit për ndonjë pyetje/ problem/tekst secili nga nxënësit “vëndon në kokë një kapelë” dhe përkatësisht në kapelë përfaqëson pikëpamjen. Nxënësit mund të punojnë në grup, ti shkëmbejnë dhe ti shënojnë mendimet, të sjellin ndonjë vendim që do ta shpërndajnë me të tjerën paralelen. Pozicionet e “bartësve të kapelave të caktuara” shfrytëzohen si argumente. <table border="1" data-bbox="874 1106 1385 1659"> <tbody> <tr> <td data-bbox="874 1106 1042 1330">  KAPELA E BARDHË Fakte dhe informata </td> <td data-bbox="1042 1106 1214 1330">  KAPELA E VERDHË Aspekte pozitive </td> <td data-bbox="1214 1106 1385 1330">  KAPELA E ZEZË Probleme, rreziqe </td> </tr> <tr> <td data-bbox="874 1379 1042 1603">  KAPELA E KUQE Ndjenja, reagime pozitive </td> <td data-bbox="1042 1379 1214 1603">  KAPELA E GJELBËRT Zgjidhje kreative </td> <td data-bbox="1214 1379 1385 1603">  KAPELA E KALTËRT Mbledhje dhe organizim </td> </tr> </tbody> </table>	 KAPELA E BARDHË Fakte dhe informata	 KAPELA E VERDHË Aspekte pozitive	 KAPELA E ZEZË Probleme, rreziqe	 KAPELA E KUQE Ndjenja, reagime pozitive	 KAPELA E GJELBËRT Zgjidhje kreative	 KAPELA E KALTËRT Mbledhje dhe organizim
 KAPELA E BARDHË Fakte dhe informata	 KAPELA E VERDHË Aspekte pozitive	 KAPELA E ZEZË Probleme, rreziqe						
 KAPELA E KUQE Ndjenja, reagime pozitive	 KAPELA E GJELBËRT Zgjidhje kreative	 KAPELA E KALTËRT Mbledhje dhe organizim						

V. DITARËT PËR MËSIM

	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
1.	DITARI PËR MËSIM.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Ju mundëson nxënësve që ta tregojnë përparimin në një periudhë më të gjatë dhe ta tejkalojnë sindromin “çka mësuam dje?” ◆ Nxënësit në këtë mënyrë e ushtrojnë edhe shkrimin. ◆ Arsimtari fiton qasje në përparimin e nxënësve dhe ka mundësi që ti jep udhëzime konkrete. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Në fund të ditës nxënësit në ditar shkruajnë për ate se çka kanë mësuar, çka kanë mësuar më mirë, çka ju është dukur më interesant, cilat pyetje i parashtrajnë etj. Ditari udhëhiqet për çdo ditë. ◆ Arsimtari kohë pas kohe e kontrollon dhe ju jep nxënësve informatë kthyesë me shkrim për përparimin.
2.	DITARI REFLEKSIV.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxit nxënësit të mendojnë për të mësuarit e tyre. Për këte në fillim kanë nevojë për përkrahje për shkak se nxënësit më tepër përshkruajnë se sa analizojnë. ◆ Veçanërisht janë përshtatëse për refleksion në lidhje me leximin e literaturës kur nxënësi mund ti shkruan mendimet dhe gjykimet e veta.. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Në fund të çdo aktiviteti nxënësit marrin detyra – për disa minuta të mendojnë dhe t’ju përgjigjen pyetjeve vijuese: <ul style="list-style-type: none"> I. A të ndihmoi detyra të dijshe? II. A tu duk interesant? III. Si mësove?



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
3.	KOHA PËR REFLEKSION.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Për të mësuarit thelbësorë me rëndësi është që të sigurohet kohë për tu procesuar informatat. ◆ Te nxënësit nxiten procese mendore dhe përvetësohet dituria metakognitive. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Arsimtari i nxit shkathtësitë mendore kyçe të cilat nxisin refleksion dhe e tërë paralelja e kalon kohën duke biseduar për ate se si e kanë mësuar diçka. ◆ Arsimtari kërkon nga nxënësit të mendojnë për përvojat e tyre nga të mësuarit: <ul style="list-style-type: none"> ▶ U vetëdijësova për ... ▶ Isha i befasuar nga ... ▶ Më nxiti të mendoj për ... ▶ Mësova se

VI. PORTFOLIO

	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
1.	PORTFOLIO LETRE OSE DIGJITALE (ELEKTRONIKE).	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit mund ta ndjekin përparimin vetanak dhe ta dokumentojnë përparimin. ◆ Nxënësit aftësohen ta vlerësojnë kualitetin e punimeve. ◆ Arsimtari ka fakte për gjykimet/notat që i ka dhënë. ◆ Portfolioja digjitale është më e lehtë për ta ruajtur. Nxënësit i ushtrojnë shkathtësitë të tyre të TIK-ut. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Arsimtari i udhëzon nxënësit se si të zgjedhin punime dhe të shënojnë pse ndonjë punim është zgjedhur. ◆ Portfoliot mund të jenë zhvillimore (zgjidhen punime të cilat tregojnë përparimin - si për shembull: në shkrimin e hartimeve me shkrim), ose reprezentative (zgjidhen punimet më të mira - si për shembull: vjersha më e mirë, hartimi më i mirë kreativ, përmbajtja me argumentin më të mirë dhe ngjashëm).. ◆ Arsimtari gjithashtu, për nevojat e veta mund të bën portfolio për nxënësit.

VII. PYETJE, NXITJE

	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
1.	ESE PËR NJË MINUTË.	<ul style="list-style-type: none"> Arsimtarit i mundëson që shpejtë të vëren se nxënësit a e kanë përvetësuar idenë kyçe. 	<ul style="list-style-type: none"> Në fund të orës arsimtari parashtron pyetje të shkurtër ese e cila mund të përgjigjet për disa minuta. Përgjigjet i kontrollon pas orës.
2.	ANALOGJITË.	<ul style="list-style-type: none"> Arsimtarit i mundëson që shpejtë të vëren se nxënësit a i kanë kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet koncepteve. I nxit proceset mendore më të zgjeruara te nxënësit. 	<ul style="list-style-type: none"> Shembull: Pas përpunimit të procesit të shumimit, nxënësit duhet ta gjejnë dhe ta sqarojnë analogjinë vijuese: Pula dhe veja janë të lidhura njësoj sikur _____ dhe fara për shkak se _____.
3.	REZYME NË NJË FJALI.	<ul style="list-style-type: none"> I nxit nxënësit që ti identifikojnë gjërat me rëndësi. Nxënësit aftësohen për shprehje konçize. Arsimtari fiton informata për të kuptuarit e mësimin. 	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit shkruajnë rezyme në një fjali e cila i përgjigjet pyetjeve: kush, çka, kur, ku, pse, lidhur me përmbajtjen që është mësuar. Kjo është e përshtatshme për mbledhjen e përmbajtjeve nga tekstet letrare të lexuara dhe nga hulumtimet në shkencat natyrore.
4.	PËRMBLEDHJA NË NJË FJALË.	<ul style="list-style-type: none"> I nxit nxënësit në të menduarit më të thellshëm. Për arsimtarin është mënyrë e mirë për mbikqyrje në mënyrën e të menduarit të nxënësve. 	<ul style="list-style-type: none"> Çdo nxënës duhet të thotë një fjalë që më së miri e thotë të prezantuarën. Fjalët nuk guxojnë të përsëriten. Arsimtari mund të pyet se si fjala është e lidhur me gjërat e mësuara.



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
5.	3 - 2 - 1.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit aftësohen për tërheqjen e ideve kyçe, nxiten për zgjerimin e diturive, bëjnë lidhshmërinë e diturive me përvojat. ◆ Arsimtari shpejt fiton informata për të kuptuarit e përmbajtjeve të cilat mund ti shfrytëzon gjatë planifikimit dhe realizmit të mësimdhënies, për individualizim dhe diferencim të qasjes. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Në fund të temës/orës çdo nxënës shkruan ose tregon gjëra të rëndësishme që i ka mësuar. Si psh: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Tre gjëra që i mësove ▶ Dy gjëra interesante ▶ Një pyetje për të cilën ende nuk ke përgjigje ▶ ose ▶ tre fjalë kyçe ▶ dy ide të reja ▶ një mendim që të preokupon ◆ ose <ul style="list-style-type: none"> ▶ tre pyetje të lidhura me tekstin (për shembull: fjalë të panjohura, pjesë të paqarta) ▶ dy parashikime në bazë të asaj që është lexuar (çka do të ndodh në vijim) ▶ një lidhje me ty (diçka që e dijshe ose të ka ndodhur ty). ◆ Qasje e njejtë mund të shfrytëzohet në fillim të orës, po pyetjet kanë të bëjnë psh: Me detyrën e shtëpisë ose me ate që e kanë mësuar në temën paraprake .



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
6.	"MOS U HIDHËRO NJERI".	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit mësojnë njëri nga tjetri në mënyrë interesante. ◆ Arsimtari fiton informata për arritjen e qëllimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit ndahen në grupe nga 4. Çdo grup merr nga 6 pyetje lidhur me temën dhe një kub për "mos u hidhëro njeri". Çdo nxënës e hudh kubin dhe përgjigjet në pyetjen me numrin që i ka ra. Nëse i bije numri i njetë, nxënësi përsëri duhet ta zgjeron ose ta arsyeton përgjigjen. ◆ Arsimtari mundet nga anash ta ndjek "lojën" dhe ta vëren kualitetin e përgjigjeve.
7.	DIKUSH, DIÇKA, POR, SIPAS ASAJ.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Përmirësohen aftësitë për të shkruar. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit mendojnë, shkruajnë ose shpjegojnë tregim me strukturë të dhënë (personazh(e), ngjarje, probleme, zgjidhje) dhe e shënojnë ose e shpjegojnë.
8.	UNË E KAM PYETJEN, KUSH E KA PËRGJIGJEN.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit mësojnë njëri nga tjetri. ◆ Arsimtari fiton informata për të kuptuarit dhe përmbajtjet e mësuara. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Arsimtari përgatit pyetje dhe përgjigje në ta në lidhje me përmbajtjet e mësuara. Mund ti përgatit së bashku me nxënësit. Shënohen në kartuça/fleta të veçanta. Çdo nxënës merr nga një fletë. Nxënësi i cili ka pyetje e lexon para të gjithëve, ndërsa duhet të paraqitet nxënësi i cili e ka përgjigjen asaj pyetje. Nxënësit e tjerë vendosin se a është ajo përgjigjia e vërtetë.



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
9.	KUIZET.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Arsimtarit dhe nxënësit i mundësojnë kontrollim të shpejtë të diturive dhe të përmbajtjeve dhe përparimin në raport me rezultatet e pritura. ◆ Arsimtari të dhënat i shfrytëzon menjëherë për ta riaftësuar mësimdhënien e vetë. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Kohë pas kohe arsimtari shfrytëzon kuize të cilat përbëhen nga numri i caktuar i pyetjeve të cilave mundet shpejtë ti përgjigjen. Mund të jenë me zgjedhje shumë anëtarëshe ose përgjigje të shkurtëra. ◆ Përgjigjet e nxënësve, veçanërisht përgjigjet e gabuara, mund të jenë nxitje për diskutimin e mëtutjeshëm dhe dhënien e sqarimeve plotësuese. ◆ Pyetjet (dhe përgjigjet) mund të jenë të përgatitura si aplikacion kompjuterik.
10.	KATËR KËNDE – KATËR PYETJE.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Ju ndihmon nxënësve që të kenë pasqyrë në ate se sa mirë kanë mësuar. ◆ Arsimtarëve ju ndihmon për ti “grupuar” nxënësit sipas llojit të gabimeve në të kuptuarit dhe t’ju jep përkrahje adekuate. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit në një fletë letre të ndarë në 4 pjesë përgjigjen në 4 pyetje lidhur me të mësuarit dhe të menduarit. Pyetjet kanë të bëjnë si për shembull me: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Përkufizime <ul style="list-style-type: none"> ◆ _____ <i>d.m.th</i> ... ▶ Sqarime <ul style="list-style-type: none"> ◆ Një mënyrë për tu shfrytëzuar kjo është ... ▶ Krahasime <ul style="list-style-type: none"> ◆ Kjo është ngjashëm me ... ▶ Relevancë <ul style="list-style-type: none"> ◆ Duke e ditur se _____ pyetem ... <p>Arsimtari me nxënësit bisedon për ate se çka kanë mësuar. Mundet shpejtë ti grupon nxënësit sipas asaj se në cilën lloj të pyetjeve kanë patur vështirësi dhe të formon grupe të cilave do t’ju jep instruksione dhe aktivitete plotësuese.</p>

VIII. DISKUTIM

	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
1.	NXËNËSIT PARASHTROJNË PYETJE NJËRI TJETRIT.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ I nxit nxënësit të mendojnë për ate që nuk e kanë kuptuar. ◆ Nxënësit mësojnë njëri nga tjetri. ◆ Promovohet të mësuarit kolaborativ “më shumë koka më mirë mendojnë”. ◆ Zhvillohen aftësitë për të dëgjuar dhe për të diskutuar. ◆ Ndhmon që të vendosen rregulla për punë të përbashkët. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Shembull: Nxënësit diskutojnë për të dhënat paraqitura në grafik. Secili tregon nga një të dhënë deri sa nuk shtrydhen të gjitha informatat që mund të fitohen nga grafiku. ◆ Nxënësit i prezantojnë rezultatet nga hulumtimi i realizuar të tjerët ju parashtrojnë pyetje. Arsimtari luan rolin e moderatorit në diskutim.
2.	PARTNER PËR BISEDIM.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Jep pasqyrë për të mësuarën. ◆ Jep mundësi të ndrohet përqëndrimi i mësimit nëse është e nevojshme. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësit në çifte bisedojnë për: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Tre gjëra të reja që i kanë mësuar, ▶ Çka kanë patur të lehtë, ▶ Çka kanë patur të rëndë, ▶ Çka dëshirojnë ende të mësojnë, Pastaj ate e shkëmbejnë me tjetër çift.
3.	NXËNËSIT VENDOSIN PËR PËRGJIGJEN.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mundëson që nxënësit të vlerësojnë saktësinë e përgjigjes dhe të diskutojnë për gabimet të cilat paraqiten shpesh. ◆ Ndhmon që të parashtrihen standarde të njejta. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Arsimtari i pyet nxënësit të mendojnë se a është ndonjë përgjigje e mirë, çka dëshirojnë të shtojnë, çka dëshirojnë të ndryshojnë, çfarë përgjigje do të jepnin ata. ◆ Si për shembull: nxënësit japin mendim për përgjigjen: Kur mblidhen numrat dhjetorë fitohet numër dhjetorë.



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
4.	MENDO, SHPËRNDAJ, SHKËMBE.	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit mësojnë njëri nga tjetri. Nxënësit i risin standardet vetanake për përgjigje kualitative. Arsimtari fiton informatë për të kuptuarit. 	<ul style="list-style-type: none"> Arsimtari ju jep udhëzime për tu përgjigjur në pyetje/detyre. Çdo nxënës formulon përgjigjen e vet (mund edhe ta shkruan) dhe e shkëmben me shokun e vet. Bisedojnë për ate se çka është mirë në njërën dhe në përgjigjen tjetër, dhe çka mungon. Arsimtari thëret disa çifte për ti shkëmbyer përgjigjet me nxënësit e tjerë.

IX. VËZHGIM

	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM															
1.	ÇEK - LISTA PËR VËZHGIM.	<ul style="list-style-type: none"> Ju ndihmon nxënësve që të orientohen ë aspekte konkrete të realizimit. I fokuson nxënësit në qëllimet kyçe dhe rezultatet e pritura. 	<ul style="list-style-type: none"> Vëzhgimin mund ta bën arsimtari ose nxënësit të vëzhgohen në mënyrë të ndërsjelltë. Shembull: Në orën e gjuhës ose gjuhës së huaj nxënësit i notojnë prezantimet gojore. <table border="1"> <thead> <tr> <th>KRITERI</th> <th>Nxënësi A</th> <th>Nxënësi B</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Shfrytëzon kohën e kaluar</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Shfrytëzon kohën e tashme</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Shfrytëzon kohën e ardhëshme</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Mban vëmendjen</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	KRITERI	Nxënësi A	Nxënësi B	Shfrytëzon kohën e kaluar			Shfrytëzon kohën e tashme			Shfrytëzon kohën e ardhëshme			Mban vëmendjen		
KRITERI	Nxënësi A	Nxënësi B																
Shfrytëzon kohën e kaluar																		
Shfrytëzon kohën e tashme																		
Shfrytëzon kohën e ardhëshme																		
Mban vëmendjen																		



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM																		
2.	ÇEK - LISTA PËR NOTIMIN E NDËRSJELLTË.	<ul style="list-style-type: none"> Ndihmon procesin për notim të ndërsjelltë nëpërmjet të të treguarit dhe ushtrimit të procesit . 	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë aftësimit të nxënësve për notim të ndërsjelltë, në fillim nxënësit aftësohen që me kujdes të vëzhgojnë dhe të dëgjojnë se çka punojnë nxënësit e tjerë. Si për shembull formohen treshet nga nxënësit. Njëri nxënës e ka notuar punën e nxënësit tjetër dhe i jep informatë kthyese. Nxënësi i tretë vëzhgon dhe noton se si jepet informata kthyese. <table border="1" data-bbox="823 909 1318 1541"> <thead> <tr> <th>KRITERI</th> <th>Nxënësi A</th> <th>Nxënësi B</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Vendosja e kontaktit me sy</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>I thekson të arriturat dhe tregon gabimet</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Komentet kanë të bëjnë me punën</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Komentet i argumenton me fakte</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Jep sygjerrime për përmirësim</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	KRITERI	Nxënësi A	Nxënësi B	Vendosja e kontaktit me sy			I thekson të arriturat dhe tregon gabimet			Komentet kanë të bëjnë me punën			Komentet i argumenton me fakte			Jep sygjerrime për përmirësim		
KRITERI	Nxënësi A	Nxënësi B																			
Vendosja e kontaktit me sy																					
I thekson të arriturat dhe tregon gabimet																					
Komentet kanë të bëjnë me punën																					
Komentet i argumenton me fakte																					
Jep sygjerrime për përmirësim																					
3.	SHËNIME ANEKDOTIKE.	<ul style="list-style-type: none"> Arsimtari siguron informata nga vëzhgimi kalimthi. 	<ul style="list-style-type: none"> Arsimtari ka në disponim fleta ose fletore ku i shënon sjelljet jo të zakonshme (në kuptim pozitiv ose negativ) lidhur me të mësuarit. Si për shembull ndonjë nxënës i dobët me sukses e ka zgjidhur detyrën e vështirë, ndonjë nxënës ka dhënë argumentim origjinal gjatë diksutimit në grup. 																		



	STRATEGJI / TEKNIKA	DOBITË KYÇE	KAHJE DHE SHEMBUJ PËR SHFRYTËZIM
4.	VIDEO.	<ul style="list-style-type: none"> Mundëson që nxënësit ta vetënotojnë sjelljen vetanake. 	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit shikojnë inçizim të ndonjë aktiviteti , si për shembull: prezantim gojor dhe vetënotohen sipas kritereve të dhëna.
5.	LOJA NË ROLE.	<ul style="list-style-type: none"> Mundëson që nxënësit ti “provojnë” disa zgjidhje ose mendime pa u ndjerë keq. 	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit luajnë role për ate se si të zgjidhet ndonjë situatë krize. Pastaj diskutohen anët e mira dhe të dobëta nga zgjidhjet e “roleve”.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Мицковска Г. (2007), Потсетник за оценување, Проект за основно образование, УСА-ИД, Македонски центар за граѓанско образование, Скопје.
2. Нацева Б., Мицковска Г., Попоски К. (2001), Описно оценување на постигањата на учениците од I, II и III одделение на основното училиште, Биро за развој на образованието, Скопје.
3. Хавелка Н., Хабиб Е., Бауцал А., (2003) Оцењивање за развој ученика, http://www.researchgate.net/publication/233823287_Оценјивање_за_развој_уеника
4. Шел Т.Ц., Марчан Д. П., Попоски К., Мицковска Г., (2006), Примена на стандардите за оценување на учениците, Материјали за обука, Проект за основно образование, УСА-ИД, Македонски центар за граѓанско образование, Скопје.
5. Assessment for Learning and Development in k-3, (2013), K-3 Assessment Think Tank, North Carolina, <http://www.dpi.state.nc.us/docs/earlylearning/k3-assessment.pdf>
6. Black P., Wiliam D.,(2003), 'In praise of educational research': formative assessment, *British Educational Research Journal*, 29 (5). стр. 623-637.
7. Black, P. & Wiliam, D. (2009). Developing the theory of formative assessment. *Educational Assessment, Evaluation and Accountability*, 21(1), 5-31.
8. Božin., S. Milović, A. Pašalić, B. Schröder., Božin S. (уредници), *Svatko uci na svoj nacin*, Agencija za odgovj I obrazovanje, Zagreb, 2011, http://www.azoo.hr/images/izdanja/Svatko_uci_na_svoj_nacin_web.pdf
9. Curriculum for excellence, Building the curriculum 5, A framework for assessment Scottish Government, February 2011, https://www.educationscotland.gov.uk/Images/BtC5Framework_tcm4-653230.pdf
10. Formative Assessment That Truly Informs Instruction, National Board of Teachers of Englisch, 2013, http://www.ncte.org/library/NCTEFiles/Resources/Positions/formative-assessment_single.pdf
11. Guide to Assessment, Scottish Qualifications Authority 2008, http://www.sqa.org.uk/files_ccc/25GuideToAssessment.pdf
12. Heritage M., (2010), Formative Assessment and Next-Generation Assessment Systems: Are We Losing an Opportunity?, CRESST, <http://files.eric.ed.gov/fulltext/ED543063.pdf>
13. Heritage M., (2008), Learning Progressions: Supporting Instruction and Formative Assessment, <http://www.k12.wa.us/assessment/ClassroomAssessmentIntegration/pubdocs/FASTLearningProgressions.pdf>
14. Murchan D., G. Shiel, E. Vula, A. Gashi Bajgora, V. Balidemaj, Formativno ocenjivanje, USAID, FHI 360, Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije Kosova, 2013 http://bep-ks.org/wp-content/uploads/2013/10/BEP-Vleresimi-formativ_srb.pdf
15. Shepard L., (2005), Linking formative Assessment to Scaffolding, *Educational Leadership*, v. 63, n. 3, стр. 66-70.

LITERATURA E CITUAR

1. Assessment for Learning, A practical Guide (2009), Council for the Curriculum Examinations and Assessment, Belfast. http://www.nicurriculum.org.uk/docs/assessment_for_learning/AfL_A%20Practical%20Guide.pdf
2. Black P., D. Wiliam (1998). Assessment and classroom learning. *Assessment in Education*, 5(1), 7-74.
3. Carol S. Dweck, Gregory M. Walton, & Geoffrey L. Cohen, Academic Tenacity: Mindsets and Skills that Promote Long-Term Learning (http://web.stanford.edu/~gwalton/home/Welcome_files/DweckWaltonCohen_2014.pdf)
4. Epstein J.L., New Connections for Sociology and Education: Contributing to School Reform, *Sociology of Education* , Vol. 69, Extra Issue: Special Issue on Sociology and Educational Policy: Bringing Scholarship and Practice Together (1996), ctp. 6-23.
5. Ishodi učenja, Sveučilište u Splitu, Sveučilišni odjel za stručne studije (2012) http://www.oss.unist.hr/docs/kvaliteta/ISHODI_UCENJA_Prirucnik_2012.pdf
6. Ross, J. A. (2006). The reliability, validity, and utility of self-assessment. *Practical Assessment Research & Evaluation*, 11(10), 1-13.
7. Slavin R. E., E. A. Hurley, A. Chamberlain (2003) *Cooperative Learning and Achievement: T*
8. The Role of Reflection in Teaching-Qatar University www.qu.edu.qa/.../The_Role_of_Reflection_in_Teaching
9. Vizek Vidović V., *Ishodi učenja u obrazovanju učitelja i nastavnika – konceptualni okvir*, Zagreb 2008.

ISBN 978-608-206-047-7